

HARTOHEN PLANET

Bashkë me arsenalin sirian, në Shqipëri vijnë edhe komandot e SHBA MARINSAT AMERIKANE DO TE RUAJNE ARMET KIMIKE

Nga vendi janë larguar deri tani qindra tonë lëndë helmuese në inventarin e Ushtrisë. OSBE vijon projektin për ristokimin e fuçive me substanca të rrezikshme

► Faqe 4-5-6

TRAGJEDIA

► Faqe 2



Për të marrë shinat dhe kromin, 7 të vdekur në miniera

KUVENDI

► Faqe 8-9-10



"Korça", PD tërheq aleatët në protesta, "lekë" në seancë

ARRESTIMET

► Faqe 3


Vjedhja 5.4 mln euro e TVSH, pranga tatimoreve, skema e mashtrimit

PORTO ROMANO

► Faqe 14

Çfarë po ndodh me trojet e Fazllicit dhe TEC-in me qymyrguri

PUBLIKOHET VJERSHA E VITIT 1972



VISAR ZHITI

Një natë pa gjumë

Një natë pa gjumë, i lodhur, vetëm, midis natës dhe heshtjes, roje. me automatik në dorë. Një natë pa gjumë, eci. Pa cigare, ftohtë, bie shi, këpucët e mia shtypin gurët e vetmisë, eci. Yje të lagur. Një natë pa gjumë, mbështjellë me kapotë, jam ushtar, rripi automatikut mbi supin tim. Duar vajzash më janë varur mbi supe, gishta të gjatë, të bukur, duar që s'i ndërroja me asgjë në botë, tani ky automatik, më i sigurt se çdo dorë, i përjetshëm deri në komunizëm. Një natë pa gjumë, dhe të tjerë nuk flenë, shekulli im nuk fle, horizontet tunden si afishe, të flakura nga era, bie shi me gëzhoja, njomen kapotat e ushtarëve, me kapotë të njomur, me automatik në dorë. Është koha të shikohet më tepër tanke se karroca femijësh.

Visar Zhiti: Në gji një vëllim të shokut Enver, automatiku deri në komunizëm

Teodor Laço: Fjalimi i shokut Enver, një dritë e madhe për ne

► Faqe 16-17

SHTRENGOHEN MASAT

Policia: Pranga shoferëve që lëvizin pa dokumenta

Vetëm dje 8 arrestime në Kavajë të kapur pa letra

NERANXI
... gjithmonë një hap përpara...
Lëndë të para për restorante, piceri, kreperi dhe fast food.

TIRANE

MARIGLEN MULLA

Policia e Shtetit arrestoi dje 8 persona në Kavajë, pasi nuk kishin patentat me vete. Nga sot e tutje, policia do të arrestojë çdokënd që drejton një...

► Faqe 12



Satirë politike



NGA ARBEN DUKA

Këshilla falas për Bashën dhe opozitën

Pjesa e parë

Orë e opozitës, duhet të kurdiset, se tani PD-ja, shumëqeq po braktiset!

Nga gjithë nivelet, ka rjedhje çdo ditë, siç duket nuk duan, të jenë opozitë...

► vijon në faqen 21

bashkë me rubrikën "VIP-a dhe Fripa"

Koment



NGA ILIR DHIMA

Goja që shqipton fjalët e ligjit

Po, kështu është përkufizuar në përgjithësi që prej dy shekujsh roli i gjyqtarit, veçanërisht në traditën e shteteve me legjislacion të kodifikuar. Kësaj tradite i përkasim ne. Prandaj, veç të tjerave, edhe Ligji Themelor i Republikës së Shqipërisë urdhëron që gjyqtari në ushtrimin e funksionit të tij duhet të zbatojë vetëm Kushtetutën dhe ligjin...

► vijon në faqen 15



Basha ngushëllon viktimat

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka ngushëlluar familjarët dhe të afërmit e 7 viktimave që humbën jetën dje në minierë, 5 në minierën e fshatit Beragozhd, në komunën Dardhas, në Pogradec dhe 2 të tjerë në minierën e Librazhdit. "Ngushëllime familjarëve të 7 viktimave, ky bilanc tragjik i shënuar sot është një tronditje e madhe për mua dhe për çdo shqiptar, fjalët janë të pamjaftueshme për të ngushëlluar familjet, Zoti u'a lehtësoftë dhimbjen", -ishite përmbajtja e mesazhit ngushëllues të kreut të PD-së, Lulzim Basha.



Rama: Fakt se ka varfëri

Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama shprehu dje keqardhjen për humbjen e jetës së pesë të rinjve në minierën e Beragozhdit, në Pogradec. Ai tha se "Ne shohim varfërinë e njerëzve që na kërkojnë ndihmën që ua jep ligji. Personat me aftësi të kufizuar nuk morën paratë e tyre, sepse atë shumë parash e bëtë rrush e kumbulla për fushatën e 23 qershorit". Në fjalën e tij në Kuvend, kryeministri theksoi se "Ky është një tjetër fakt i varfërisë së skajshme që është në vendin tonë, për shkak të keqveerisjes 8-vjeçare të demokratëve".

TRAGJEDIA/ Pogradec, vdesin pesë të rinj, hynë për të marrë shinat

Kthehet "vdekja e galerive" minierat përpijnë 7 të varfër

Librazhd, kromi zë poshtë inxhinierin dhe punëtorin



Sazan Maholli



Arjan Maholli



Edison Maholli



Ledio Maholli



Nertil Maholli

LAJMI

Shtatë viktimat është bilanci tragjik i ditës së djeshme, ku në Pogradec vdiqën 5 të rinj dhe në Librazhd 2 të tjerë. Në Beragozhd, 3 vëllezër e 2 kushërinj hynë për të marrë skrap, ndërsa në Gurrë ra një masiv kromi.

■ ■ ■ **TIRANE**
MARIGLEN MULLA

Në Beragozhdin e largët të Pogradecit, hyrja në minierat e braktitura, për të marrë shinat e galerive, u shndërrua në tragjedi, kur vdiqën 5 të rinj nga ky fshat, të asfiksuar nga gazi. Sakaq, në Gurrën e Librazhdit, rënia e masivit të kromit, ka marrë jetën e 2 personave. Që në orën 23.00 të së mërkurës, 3 vëllezërit Hamolli, 23-vjeçari Edison, 25-vjeçari Nertil dhe Ledioni, 24 vjeç, bashkë me 2 djemtë e xhaxhait, 24-vjeçarin Sazan Hamolli dhe Arjanin, 29 vjeç, kishin hyrë në minierën e braktitur, me synimin për të marrë shinat e galerive të rrënuara e të mbyllura prej 20 vitësh. Ata kishin marrë një gjenerator që furnizonte me energji elektrike pompën që nxirrte ujën, kur vërshimi i gazit metan dhe lëndëve të tjera, shkaktoi asfiksionin e tyre. Para pak kohësh, 3 vëllezërve u kishte vdekur i ati, teksa priste dru në pyll dhe herë pas here emigronin në Greqi, Itali apo Maqedoni, ku Ner-

tili sapo ishte kthyer. Edison kishte shkuar për të shpëtuar 4 të tjerët dhe mbeti i asfiksuar edhe vetë. Gjatë orëve të natës është nxjerrë vetëm trupi i njërit prej viktimave, Edison Hamollit, ndërsa në orët e mëngjesit edhe trupi i 25-vjeçarit Nertil Hamolli. Sakaq, Nida Hamolli, gruaja e Arjanit thotë se i telefonon të shoqit, por dikush e mbyll, ndaj shpreson se është gjallë. Aksioni për nxjerrjen e 3 trupave të tjerë të pajetë, vijoi përgjatë gjithë mbrëmjes së



djeshme, pas ndërprerjeve, për shkak të rrjedhjes së gazit. Genci Hamollari, kryetar i komunës Dardhas (Beragozhd) bëri thirrje për mbylljen e mini-

erave, duke shtuar se komuna do të mbulojë të gjitha shpenzimet e varrimeve. Ministria e Energjisë dhe Industrisë tha se do të vazhdojë operacionin për

të nxjerrë nga miniera edhe tre trupave të tjerë, por aksionet janë ndërprerë për shkak të nivelit të lartë të gazit. MEI thekson se aksioni do të rifillojë

Kërkimet

Deri në orët e vona të mbrëmjes, ekspertët të Ministrisë së Ekonomisë dhe të policisë, futën ajër brenda minierës, në rrugë artificiale, për të mundësuar lehtësimin e hyrjes në galeri, për të nxjerrë trupat e pajetë që kanë mbetur brenda. Pas operacionit do të bëhet edhe një bilanc.

Në foto: Ekspertët duke nxjerrë trupat e të rinjëve nga miniera

sapo niveli i gazit të ulet. Sakaq, një tjetër aksident u shënuua dje në një minierë, në Librazhd në pronësi të Agim Yzos. Dy punëtorë të minierës së kromit në fshatin Gurrë janë zënë përposhtë nga një masiv mineral kromi duke gjetur vdekjen. Të vdekur kanë mbetur inxhinier Drini Bogdani dhe punëtori Haxhi Danga, banor në një fshat të komunës së Qukësit.

Reagon ministria

Minierat i kërkuan ndihmë Berishës e ministrave

■ ■ ■ **TIRANE**

Ministria e Ekonomisë sqaron se "Shoqëria "Albminiera" s.h.a, e cila menaxhon me aktivitetin e saj territoret e 33 ish minierave, të shtrira në 4 prefektura ka bërë me dije në disa raste të përsëritura institucionet përgjegjëse për situatën e vështirë financiare dhe pamundësinë për të kryer funksionet. Konkretisht, Albminiera i ka shprehur këtë shqetësim Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës 4 herë (shkresat: Nr.124, datë 05.09.2011;



Policia në vendin e ngjarjes

Nr.46, datë: 16.03.2012; Nr.124, datë: 07.11.2012; Nr.26./1, datë 29.04.2013) dhe Ministrisë së Financave me shkresën Nr.26, datë: 20.03.2013. Duke mos gjetur zgjidhje i është drejtuar edhe Kryeministrit të Republikës me shkresën Nr.124/1, datë: 30.11.2012. Në këto shkresa, shoqëria aksionere "Albminiera" sqaron se menaxhon me aktivitetin e saj territoret e 33 ish minierave. Në organikën e saj, shoqëria ka vetëm 33 roje për të ruajtur asetet e këtyre ish-minierave, ku do duheshin 120 roje për 3 turnet. Një situ-

atë e tillë e ka bërë thuajse të pamundur kontrollin dhe ruajtjen e territoreve të 33 minierave në juridiksionin e "Albminiera" sha. Aktualisht, shoqëria ka të miratuara nga Këshilli Teknik i AKBN-së, si e vetmja strukturë që ka tagrin ligjor për këtë proces, Projektet me Preventivat përkatëse për 290 punime minierare të hapura, 66 prej të cilave janë mbyllur pas urdhërit të ministrit në vitin 2008. Për të realizuar "Mbylljen" e 224 punimeve minierare të hapura, sipas preventivave të mbylljes, nevojiten 62,566,911 lekë".

Reagimet



TAHIRI

Ministri i Brendshëm Saimir Tahiri shkruan: "Ditë e trishtë dhe e rëndë. Qoftë e lehtë për familjarët e 7 djemve që humbën jetën në luftën e tyre të dhimbshme për të vrarë varfërinë. Kjo që ndodh sot me minierat dhe humbjen e jetës së djemve të pafajshëm, është trashëgimia më e hidhur që na ka lënë pushteti i kaluar. Por që duhet shembur menjëherë..."



PD-ja

Partia Demokratike tha se "Ne kërkojmë që autoritetet e ngarkuara për sigurinë dhe menaxhimin e minierave të mbajnë përgjegjësi dhe kërkojmë që drejtësia të vihet menjëherë në lëvizje për këtë tragjedi. Ne kërkim të Kryeministri i vendit të mbajë përgjegjësi."



AKTUALITET

Vlorë, policia bllokoi gomonen, dyshime për trafik droge



Një aksion i policisë së Vlorës ka sjellë bllokimin e një gomone 8 metra të gjatë si dhe ka arrestuar drejtuesin e saj. Sipas burimeve të policisë, gomonia ishte pikasur që në brigjet e Karaburunit, por bllokimi i saj u realizua në Radhimë, dhe se drejtuesi i saj tentoi të largohej dhe ta braktiste.

Shërbimet e "Delta Forcë" të inkuadruara në operacion nga toka bënë të mundur kapjen e drejtuesit, 35-vjeçarit nga Vlora, Dejvi Aliaj, cili është shoqëruar për në ambientet e drejtorisë së policisë së Vlorës për veprime procedurale të mëtejshme. Sipas policisë, gomonia mund të jetë përdorur për trafik

droge. Gjatë kontrollit të saj, nuk është konstatuar ndonjë lëndë e dyshimte narkotike, por burime pranë policisë së Vlorës thanë se Dejvi Aliaj mund ta ketë hedhur lëndën narkotike në det, ose ka dalë në lundrim për të marrë sasinë e drogës, në vendin ku mendohet se kishte lënë takim me trafikantët.

Skema u përdor në 5 muaj, ja emrat e 11 kompanive të përfshira

Vjedhja 5.4 mln euro e TVSH, pranga tatimorëve

Në burg edhe drejtoresha e Tiranës, shtatë në kërkim

LAJMI

Një dëm prej 5.4 milion euro i është shkaktuar shtetit shqiptar nga një skemë vjedhje me rimbulsimin e TVSH-së. Janë 11 kompani kineze që kanë funksionuar deri në 2005 dhe kanë falimentuar, por sërish statusi i tyre është riaktivizuar në QKR nga dy shqiptarë dukë bërë blerjen e tyre fiktive. Më pas në këtë lojë kanë hyrë dhe punonjës të tatimeve, duke arritur të vjedhin 5.4 milion euro

TIRANE

ELTON QYNO

QERSHOR-TETOR

Të gjitha veprimet kanë ndodhur brenda periudhës Qershor-Tetor 2013 dhe bazuar në kërkesën për ç'registrim, organi tatimor rajonal ka kryer veprimet e likuidimit të detyrimeve dypalëshe, si rezultat i të cilave është dhënë edhe rimbursimi i TVSH-së si detyrim i organit tatimor ndaj shoqërive



KOMPANITË KINEZE

1. "Sheng Da Ana"
2. "Ventura"
3. "Nam Kéong"
4. "Lumturia"
5. "F M Import-Eksport"
6. "Hong De"
7. "Tong Da Horizonti"
8. "Be-Ni-Sa"
9. "Asterix"
10. "Tai-ping-Yong"
11. "Tirana HQ Import-Eksport"

LAJME SHKURT



Itali, kapet shqiptari me 1.5 kg heroinë
Kishte ardhur nga Shqipëria në fund të tetorit, me një vizë të vlefshme të dhënë nga ambasada italiane në Shqipëri. Në disa ditë ai ishte në gjendje të shiste 1.5 kg heroinë, me një vlerë tregu prej 45 mijë euro, ose 20 euro për gram. Në rekomandimin e disa qytetarëve dhe në sajë të informatorëve në zonë, oficerë nga skuadra e policisë, kanë arrestuar një 22 vjeçar shqiptar, banues në Reggio Emilia, të quajtur Ibrahim Gjordumi, ndërtdihës, i cili kishte ardhur me detyrën e vendosjes së 2 dhe 3 kg. Droga erdhi në Itali nga Shqipëria, nëpërmjet Greqisë, Turqisë dhe nga Afganistani, pasi ka qenë e "prerë" me paracetamol.

Shkodër, kapet 28-vjeçari me armë pa lëjë
Një 28 vjeçar nga Shkodra është plagosur me armë zjarri në orët e mesnatës, në afërsi të qëndrës së qytetit, ndërsa Policia ka nisur hetimet për kapjen e autorit. Burime zyrtare nga Policia lokale bëjnë të se, ngjarja ka ndodhur mesnatën e djeshme, në Lagjen "Salo Halli", në vendin e quajtur "Pesë Katëshi me Urë", ku 28 vjeçari Ledian Muslija, banor i Shkodrës është qëlluar me armë zjarri. Autor i plagosjes së 28 vjeçarit dyshohet të jetë 23 vjeçari Renald Terolli. Policia ka nisur hetimet për kapjen e autorit të dyshuar të ngjarjes, ndërsa i plagosuri, 28 vjeçari Muslija, ndodhet në Spitalin Rajonal të qytetit, në gjendje kritike për jetën.

pranë administratës tatimore Tiranë. Më pas, në përfundim të procedurave të likuidimit, sapo shoqëritë kanë marrë rimbursimin e TVSH-së kreditore të mbartur ndër vite nga shoqëritë në vlera të mëdha, kanë kërkuar ç'registrimin në organin tatimor rajonal si dhe shpalljen e falimentit pranë QKR. Të gjitha veprimet kanë ndodhur brenda periudhës Qershor-Tetor 2013 dhe bazuar në kërkesën për ç'registrim, organi tati-

mor rajonal ka kryer veprimet e likuidimit të detyrimeve dypalëshe, si rezultat i të cilave është dhënë edhe rimbursimi i TVSH-së si detyrim i organit tatimor ndaj shoqërive, duke shkelur procedurat ligjore dhe si rezultat i këtyre vepr-

meve, administratës tatimore i është shkaktuar një dëm prej 515,455,275 lekë të reja. Të gjitha këto janë cilësuar si veprime kriminale nga ana e prokurorisë dhe se për këtë kanë bashkëpunuar dhe shtetasit Afërdita Hysa, ish-drejtor

e Kontrollit Tatimor dhe Tahir Kuka, ish-inspektor i Procedurave të Rimbursimeve, të dy tashmë të arrestuar. Ndërkohë që janë shpallur në kërkim Ismail Muça, ish-drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, Lauren Vata ish-përgjegjës i Sektorit të Kontrollit Tatimor, Edmond Osmani, Gramos Milushi, Kujtim Metaliaj, që të tre ish-inspektorë të Kontrollit Tatimor, si edhe biznesmenët Mirjan Beneja, dhe Gjergji Tupe.

Gafa e politikës

Publikimi i emrave para kohe solli arratisjen e 7 të akuzuarve

TIRANE

Publikimi i emrave të personave nga ana e qeverisë, ka bërë që njësisia hetimore Task-Forcë në prokurorinë e Tiranës, të mos ketë shumë rezultat lidhur me arrestimin e individëve të përfshirë në këtë megaskandal. Nga 9 urdhër-arrestet e lëshuar nga prokurori i çështjes vetëm 2 prej tyre janë arrestuar nga ana e policisë së Tiranës, si Afërdita Hysa dhe Tahir Kuka, ndërtdihës që 7 prej tyre janë shpallur në kërkim policor. Sipas burimeve të prokurorisë së Tiranës, për kapjen e tyre janë kontrolluar disa banesa por pa rezultat. Dyshimet flasin se 7 personat e shpallur në



Prokuroria e Përgjithshme

kërkim i janë fshehur drejtësisë që në momentin kur janë publikuar emrat e tyre, ndërtdihës që dyshimet më të forta ekzistojnë se ata janë larguar jashtë shtetit. Prokuroria e Tiranës, gjatë fazës së hetimit nuk ka mundur të bllokojë dhe pasaportat e personave të dyshuar, pasi ata gjatë fazës hetimore nuk janë paraqitur asnjëherë në prokurori për tu marrë në pyetje. Aktualisht për personat që janë shpallur në kërkim policor gjykata e Tiranës ka vendosur masën e sigurimit "arrest me burg" për veprat penale të "Shpërdorimit të detyrës", "Vjedhjes me pasoja të rënda" dhe "Pastrimit të Produktëve të veprës penale", parashikuar nga nenet 248, 134/3 dhe 287 i Kodit Penal.

VJEDHJE NË 5 MUAJ

Menjëherë pas blerjes së këtyre shoqërive, përfaqësuesit e rinj të tyre, Beneja dhe Tupe kanë bërë kërkesë për likuidimin e shoqërive



ARMET KIMIKE NE SHQIPERI

Kryetari i Bashkisë së Elbasanit, Qazim Sejдини i ka kërkuar prefektit dhe strukturave të tjera lokale që të koordinojnë përpjekjet e tyre institucionale për të mos lejuar shkatërrimin e lëndëve të rrezikshme të Sirisë në ambientet e uzinës ushtarake të Mjekësit. Në një takim të mbajtur paradite në prefekturë, ai tha se nëse do jenë të vërteta komentet për

Sejdini kundër qeverisë: Jo armët kimike në Mjekës të Elbasanit

depozitimin e këtyre mbetjeve kimike në afërsi të Elbasanit, kjo do ishte një masakër tjetër mjedisore dhe jo vetëm për qytetin. "Ne nuk kemi ende dijeni nëse këto armë do të shkatërrohen në territorin e Elbasanit në Uzinën e Mjekësit. Ju si prefekt të ngriini zërin tuaj e të bëheni pengesë për këtë çështje. Dhe kjo i duhet duhej Elbasanit se pak kishte ndotje", tha Sejдини.

Nëse Tirana pranon, SHBA ofron ekspertë për asgjësim e komando për ruajtjen e bazës

Armët kimike, vijnë marinsat amerikanë


Arvizu: Shqipëria duhet të japë kontribut

LAJMI

SHBA ka piketuar Shqipërinë si një ndër vendet që do përdoret për asgjësimin e armëve kimike siriane. Eshhtë përgatitur infrastruktura, ku janë përcaktuar ekspertët dhe marinsat për demontimin dhe ruajtjen e zonës. Arvizu beson te gatishmëria e Shqipërisë.

■ ■ ■ TIRANE

JAKIN MARENA



kundër armëve kimike bashkë me 26 vendet e tjera anëtare, ne do të investojmë në specializimin për të krijuar të gjitha standardet për sa i përket luftës së armëve kimike, një rrezik kërcënues për njerëzit", tha Arvizu. Duke nënkuptuar se SHBA kërkon angazhimin e Shqipërisë, teksa ka thënë se shpreson që Shqipëria të jetë

pjesë e BE. "SHBA vlerëson dhe falenderon qeverinë e Shqipërisë për pozicionin e fortë lidhur me Rezolutën 2118 të Këshillit të Sigurimit të OKB për eliminimin e programit të armëve kimike të Sirisë. Eshhtë në dorën e të gjitha vendeve të përgjegjshme, ku përfshij siguri të SHBA dhe Shqipërinë, që të punojnë në bashkëpunim

PD, PALOKA

"Ne nuk kemi një qëndrim ende zyrtar. Personalisht them se për një vend me kushtet dhe pozitën ku jemi ne, dhe me një mazhorancë që deri dje mori vendime të bujshme për ndalimin e plehrave në Shqipëri, menjoh se është absurd të pranohet shkatërrimi i armëve kimike".



Ambasadori i SHBA në Shqipëri Alexandër Arvizu

qipëria janë anëtare krenare të NATO-s dhe vetëm 26 vende të tjera mund ta pretendojnë këtë status. Shpresojmë shumë që rruga e Shqipërisë drejt BE të vazhdojë dhe duke punuar me Shqipërinë dhe partnerët të tjerë ndërkombëtarë, presim nga të gjithë, të gjithë partnerët e përgjegjshëm, që të gjejnë mënyra për të kontribuar, qoftë në formë pajisjesh të specializuara, personelit të trajnuar, ekspertizës, ndihmës financiare, për t'u marrë me kërcënimin ndërkombëtar që kanoset nga armët kimike të Sirisë", ka nënvizuar Arvizu. Deklarata e tij vjen vetëm dy ditë pas lajmit nga Revista

amerikane 'Foreign Policy', që shkruan se Qeveria e presidenti i Sirisë Bashar Al Assad i ka dorëzuar OKB plan të detajuar për transferimin e këtyre armëve jashtë Sirisë. Destinacioni më i mundshëm i dërgimit të këtyre armëve, shkruan 'Foreign Policy', është Shqipëria ku janë shkatërruar të gjitha armët e këtij lloji të trashëguara nga ushtria komuniste e Enver Hoxhës. "Ky plan që ende s'është bërë publik koinsiston në dhënieve qeverisë shqiptare të disa laboratorëve të lëvizshëm përmes të cilëve do zhvillohet procesi shkatërrimit që njihet si "hydrolysis", thotë revista amerikane.

Protesta

Ambientalistët: Jo armë kimike siriane këtu

Shoqatat protestë para Kryeministrit dhe Kuvendit kundër futjes së armëve kimike në Shqipëri

■ ■ ■ TIRANE

Shoqata e ambientalistëve ka organizuar dje një protestë para kryeministrit kundër demontimit të armëve siriane në Shqipëri. Kanë marrë pjesë qindra persona të moshave të ndryshme të cilët kanë ngritur zërin me thirrjet "duam të jetojmë" dhe "mos na e pengoni ajrin". Sazan Guri në protestë tha se "Jemi kundër shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri. Shëndeti i familjeve është i rëndësishëm. Shqipëria s'është kosh plehrash i Europës". Analisti Mustafa Nano u ndal tek premtimet e qeverisë së sotme gjatë fushatës



elektorale për moslejimin e importit të mbetjeve në vendin tonë. Përveç lajmeve në mediat ndërkombëtare se Shqipëria është një nga vendet potenciale që mund të bëjë asgjësimin e rreth 1 mijë tonë armëve kimike nuk ka asnjë reagim nga qeveria shqiptare nëse do pranohet apo jo të bëjë demontimin. Ambientalistët e shohin këtë si një dëm të madh për vendin tonë dhe që do të kishte pasojë fatale për popullsinë Shqiptare. Protesta është mbështetur edhe nga njerëz të njohur të skenës shqiptare të cilët kanë ju kanë bërë thirrje autoriteteve të mos e ndërmarrin një veprim të tillë. Një ndër thirrjet më të shpeshta përballë kryeministritë ka qenë

"nuk e shesim shëndetin për një grusht dollar". Protesta ka vijuar përballë Kuvendit ku protestuesit i kanë bërë thirrje Kryetarit Ilir Meta, të pengojë e të mos aprovtojë një vendim të tillë që do të kishte pasojë fatale për popullsinë e sidomos për brezin e ri. Protestues të tjerë folën të irrituar, që plehrat të çohen në Rusi, aty nga janë nisur e jo të vijnë në Shqipëri që pretendon të bëhet turistike dhe po e rrit imazhin e saj me mundim nga viti në vit. Protestuesit kërkan sensibilizimin e të gjithë qytetarëve shqiptarë për t'i thënë jo bashkarisht ardhjes së armëve kimike siriane ndërsa lajmëruan një tjetër protestë ditën e shtunë. **mi. gjo.**

ARMET KIMIKE NE SHQIPERI



Ish-kryeministri demokrat 1992-1997, Aleksandër Meksi ka reaguar në lidhje me armët kimike. "Nuk dua të flas në këtë moment për këtë çështje, për importimin e armëve kimike nga Siria, por dua të them se Shqipëria më 1993 ka nënshkruar në Paris Konventën e Armëve Kimike, që ndalon zhvil-

Meksi: Kemi firmosur Konventën anti-kimike

limin, prodhimin, grumbullimin dhe përdorimin e armëve kimike dhe kërkon shkatërrimin e dy objekteve të prodhimit të armëve kimike dhe armët kimike vetë. Dhe për këtë arsye ne si vend i asgjësuar të gjitha armët kimike që ishin në vendin tonë", ka qënë deklarata e Meksit.

"Arben Imami la anijet e ushtrisë pa rezerva karburanti, ia dha PD"

"Jemi të papërgatitur s'kemi demontuar kurrë armë kimike"

Flet ish-kundëradmirali Kudret Çela: Duhet të vijmë të huajt për t'i asgjësuar



Kudret Çela, ish-kundëradmirali i Flotës Detare

■ ■ ■ TIRANE

ELTON QYNO

Kudret Çela, ish-kundëradmirali i Flotës Detare, rrëfen se vendi iunë nuk ka shkatërruar kurrë armë kimike. Çela, tregon në një intervistë për "Shqiptarja.com" se ushtria Shqiptare, ka shkatërruar lëndët helmuese luftarake, por jo armë me mbushje kimike. Sipas tij, këtu janë dy procese të ndryshme. Çela shton se nëse armët kimike siriane vijnë në Shqipëri, ato duhet të menaxhohen me teknologji moderne dhe specialistë shqiptarë dhe amerikanë.



Xhemal Gjunksi

nëse keni dijeni: kush ka qënë arsye që u "dorëzua" Xhemal Gjunksi?

Sipas mendimit tim, Gjunksi nuk mund të punonte dot me ministrin Kodheli, pasi kjo është një grua korrekte dhe e papërfolur në afëra korruptive në fushën e politikës shqiptare. E kundërta ka qënë kur ai ka punuar me ministrin Arben Imami, një ministër i përfolur për të gjitha problemet e ngritura kundra tij. Pjesë e këtyre problemeve korruptive ka

qënë dhe Xhemal Gjunksi, shtu këtu dhe problemet e etikës, në të cilat ai është përfolur. Mendoj se këtu kanë qënë ato që atij i treguan një farë vlerë për veten e vet që paraqiti dorëheqjen. Se dhe karriera e tij mendoj unë ka qënë sa abuzive aq dhe korruptive. Do të shtoja këtu se ai është rritur nga ai parimi i kërmillit, këtu referoj Solisin unë, ish-ministrin e Shëndetësisë që tha "Kur e pyeti shqiptonja kërmillin: ti si u ngjite në majë të pishës, kërmilli ia ktheu: "Erdha duke u lëpirë". Edhe Gjunksi ka qënë një nga këta, që ka ardhur duke u lëpirë në karrierë. Ai i ka thirrur ndërjegjes së vet dhe ka vendosur të marrë një akt të civilizuar për të dhënë dorëheqjen.

Jemi në momentin kur Shqipërinë e vizitoi presidenti grek dhe ministri i Mbrojtjes së këtij shteti. Një ndër pikat e diskutimit me autoritetet shqiptare ka qënë dhe marëveshja e detit. Ju keni qënë kundër admiralit i flotës detare. Cila është kështilla juaj, për qëndrimin që duhet të mbajë shteti shqiptar për këtë çështje?

Me çfarë më kujtohet në një in-

SERVILIZMI

Kur e pyeti shqiptonja kërmillin: Ti si u ngjite në majë të pishës, kërmilli ia ktheu: "Erdha duke u lëpirë". Edhe Gjunksi ka qënë një nga këta, që ka ardhur duke u lëpirë në karrierë. Ai i ka thirrur ndërjegjes së vet dhe ka vendosur të marrë një akt të civilizuar për të dhënë dorëheqjen

ulen dhe të bëjnë një marëveshje bilaterale, duke u lënë mënjantë të gjitha mendimet e kaluara të paktit të parë.

Sot e kësaj dite ju ende jeni në proces gjyqësor me ish-presidentin Topi dhe ish-ministrin e Mbrojtjes Arben Imami për largimin tuaj nga detyra. Si po shkon ky gjyq, dhe a ka marrë një ftesë Kudret Çela për të qënë sërish pjesë e Flotës Detare Shqiptare?

Unë nuk jam më në proces gjyqësor, pasi e kam fituar që në muajin prill 2013 në Apel dhe njëkohësisht ka dalë dhe Urdhëri i Ekzekutimit. Tashmë të gjithë dokumentacionin unë ia kam dërguar Ministrisë së Mbrojtjes dhe pres nga ministria Kodheli që t'i shikojë. Rikthimi në punë i atyre që kanë fituar gjyqet, jo se jam unë në këtë mes, por është bërë dhe premtim në fushatë elektorale nga ana e PS. Momentalisht akoma s'kam marrë një përgjigje nga ana e ministrisë së Mbrojtjes.

Ish-ministri Imami, është akuzuar nga zyrtarët aktualë të ministrisë së Mbrojtjes se ka përdorur rezervat e naftës të ushtrisë për fushatën elektorale të PD-së. Për këtë rast prokuroria duhet të nisë hetimet për Arben Imami?

Të gjitha akuzat që janë bërë dhe bëhen për ish-ministrin Arben Imami, mendoj se duhet të ringrihen sërish. Opozita e asaj kohe ka ngritur një komision hetimor dhe se sërish ky komision duhet të ringrihet dhe t'i zhvillojnë mbledhjet në Ministrinë e Mbrojtjes. Fakt është që është përdorur nafta, dhe këtu nuk bëhet fjalë për naftë rezervë, se kjo do të ishte gjysma e së keqes. Në këtë rast është marrë nafta që ushtria shqiptare e përdor për kryerjen e misioneve, dhe se për këtë shkak shumë misione kanë mbetur pa kryer. Anijet nuk kanë pasur karburant, s'patrullonin vijën tonë bregdetare, ushtria nuk kryente detyrat kushtetuese. Ky është krimi më i madh që është bërë nga Imami, i cili naftën e ka dhënë për fushatë dhe ua ka hequr Forcave Ushhtarake. Nëse prokuroria këto i cilëson fakte, duhet të kishte nisur hetimet.

Dekretohet Shefi i Shtabit Edi Rama propozon në krye të ushtrisë këshilltarin e Nishanit



Jeronim Bazo

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani, ka dekretoi dje me propozim të kryeministri Edi Rama në detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, Jeronim Bazon. Në këtë detyrë, Bazo zëvendëson Gjeneral Major Xhemal Gjunksin, i cili pak ditë më parë u dorëhoq. Po kështu Presidenti Nishani dekretoi lirin nga detyra të Gjeneral Gjunksit. Jeronim Bazo ka punuar së fundmi këshill-

tar Ushtarak i Nishanit, nga gushti 2012 e deri tani. Ndërsa më herët ka punuar drejtor i Planifikimit të Mbrojtjes në FA. Bazo ka kryer një sërë detyrash btë rëndësishme ushtarake ku në vitin 2007 udhëhoqi punën për planifikimin dhe zhvillimin për herë të parë të Kursit të Lartë për Studime për Sigurinë dhe Mbrojtjen. Zhvillimi i këtij kursi me pjesëmarrje ndërkombëtare ishte një ndër elementet mbështetës në

përpjekjet e Shqipërisë për t'u bërë një vend anëtar i NATO-s, në vitin 2009. Ndërkohë që gjatë periudhës 2010-2012 Bazo drejtoi Drejtorinë e Planifikimit të Mbrojtjes në SHP të FA-ve, në një periudhë e rëndësishme për Shqipërinë si një anëtare e re e NATO-s.


Pak ditë më parë, me një vendim të befte, shefi i Shtabit të Përgjithshëm Gjeneral Xhemal Gjunksi, ka dhënë dorëheqjen. Për një ushtarak të lartë, cilat mund të jenë shkaqet e një dorëheqjeje? Në rastin konkret,



ARMET KIMIKE NE SHQIPERI

Zbardhet misteri i Qafë Mollës

Fotot e operacionit të stokimit dhe ripaketimit të lëndëve kimike të ushtrisë shqiptare hedhin përfundimisht dritë mbi misterin e lëvizjeve të fuçive blu nga ana e ushtarëve me maska dhe veshje antikimike në bazën e kimisë në Qafë Mollë. Këto lëvizje u zbuluan sëpari nga TV A1 Report dhe Shqiptarja.com



Projekti i OSBE për të transferuar jashtë vendit arsenalin kinez të mbetur në vend

■ ■ ■ TIRANE

Shqipëria ka patur dhe ka një arsenal shumë më të madh nga sa mendohej të armatimeve dhe lëndëve të rrezikshme kimike në dispozicion të ushtrisë. Deri tani është folur për eliminimin e 16.6 tonëve armë kimike. Por, tani zbulohet se grumbullimi i një sasive tjetër të konsiderueshme të lëndëve të rrezikshme kimike, në inventar të ushtrisë shqiptare, për t'u larguar nga vendi, me ndihmën e OSBE-së, ka nisur në tetor të këtij viti. Ashtu sikurse vuri në dukje një ditë më parë Shqiptarja.com, Shqipëria, që po bëhet gati të pranojë armë kimike të Sirisë, të cilat do të demontoheshin nga ekspertë të huaj, në fakt ka ende vetë dhjetëra ton lëndë të para, që përdoren për prodhimin e këtyre armëve.

Tetëdhjetete tonë lëndë kimike të rrezikshme, që ndodhen në repartet ushtarake të Shqipërisë, do të ripakëtohen dhe do të grumbullohen në një vend të vetëm, për t'u ruajtur në mënyrë të sigurt, si pjesë e një projektit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, që filloi një muaj më parë. Marrëveshja për këtë qëllim ishte nënshkruar në prill të vitit të kaluar nga ish-ministri Arben Imami dhe ish-kreu i Pranisë së OSBE në Tiranë, Eugen Eörfarth.

Këto kimikate ndodheshin pranë zonave të banuara dhe paketimi ekzistues në shumicën e rasteve është thuhet plotësisht i shkatërruar, duke rrezikuar kështu jetën e njerëzve dhe mjedisin, tha kryetari aktual i Pranisë së OSBE-së në Shqipëri, ambasadori Florian Raunig. "Përmes këtij projekti, OSBE-ja synon të japë një kontribut domethënës në përmirësimin e sigurisë së qytetarëve të Shqipërisë".

Projekti mbulon 37 lloje

Ja fotot e 83 tonëve të fundit e armëve kimike në Shqipëri

Lëndët helmuese ripakëtohen dhe magazinohen në Qafë Mollë



Në foto: Lëndë kimike që ushtria shqiptare dhe OSBE ripakëtojnë dhe magazinon në Qafë Mollë

të ndryshme lëndësh kimike, përfshirë substanca të rrezikshme siç janë të dichloroaminë dhe xylenol, që ndodhen në mjedise ushtarake në Tiranë e qytete të tjera. Synohet që ato të ripakëtohen, të ruhen në mënyrë të sigurt e të përgatiten për t'u eksportuar e për t'u asgjësuar jashtë, në një fazë të mëvonshme. Rezultoni, gjithashtu se në vitin 2010 të jenë evaduar nga baza e Brarit, pranë Tiranës, drejt Belgjikës 110 ton dichloro-

mine. Aktualisht, veprimet financohen nga OSBE-ja, Republika Çeke dhe Turqia dhe kryhen nga një kompani private e kontraktuar si dhe nga stafi i Forcave të Armatosura të Shqipërisë, i cili është



LAJME SHKURT

■ Në burg se vrau gruan

Gjykata e Krimeve të Rënda vendosi dje masën "arrest me burg" për 49-vjeçarën Fehim Brajha, i cili akuzohet për vrasjen e bashkëshortes së tij, Ravdiqe Brajha, pak ditë më parë në Saur të Tiranës. Ai është paraqitur në gjykatë, ku është shprehur i penduar dhe ka theksuar sërisht se nuk donte ta vriste bashkëshorten e tij.

■ Bullgarin e shtyp kamioni

Defekti në makinë i kushtoi jetën drejtuesit të një mauneje. Ai ishte duke rregulluar defektin, kur makina ka lëvizur papritur duke e aksidentuar për vdekje. Ngjarja ka ndodhur mbrëmjen e djeshme, në afërsi të fshatit Qukës në Librazhd. Nga të dhënat paraprake, njoftohet se shoferi drejtohte maunen me targa bullgare.

■ Kapet një gomone 8 metra

Policia e Vlorës bllokoi dje një gomone 8 metra të gjatë si dhe arrestoi drejtuesin e saj. Ajo ishte pikasur që në brigjet e Karaburunit, por bllokimi i saj u realizua në Radhimë. Drejtuesi tentoi ta braktiste. Policia nuk bën të ditur identitetin e drejtuesit të gomones që mund të jetë përdorur për trafik droge.

■ Bllokohen 27 klandestinë

Policia e Fierit zhvilloi operacionin "Emigranti", gjatë të cilit kanë arrestuar dy shtetas, kanë shpallur në kërkim dy të tjerë dhe kanë shoqëruar 27 klandestinë të huaj. U kap Klodian Naci dhe Ermin Goxhaj, duke shoqëruar 27 klandestinë nga Eritrea, Afganistani, Somalia, Siria, Sudani e Pakistani, kundrejt shpërbërimit financiar.

trajnuar nga OSBE-ja.

Prezencën e OSBE-së e ka ndihmuar Shqipërinë, që nga viti 2008, në përpjekjet e saj për të asgjësuar municionet e tepërta konvencionale dhe kimikatet helmuese. Prezencën

e OSBE-së ka ndihmuar në asgjësimin e 60 tonëve përbërës toksikë të karburantit të raketave, 120 tonëve dichloroethane, si dhe ka ofruar pajisje për shkatërrimin e municioneve të tepërta.



AKTUALITET

Lezhë sekuestro pallatit 9-katësh, hetim zyrtarëve të bashkisë

Pas sekuestrimit të dy pallateve në qytetin e Vlorës të cilët rezultojnë pa lejë ndërtimi, rradha i ka ardhur një objekti 9-katësh në qytetin e Lezhës, i cili është sekuestruar gjatë ditës së djeshme. Me vendim të Prokurorisë së Lezhës, policia e këtij qyteti ka bllokuar objektin shumë katësh në qendër të qytetit të Lezhës. Ky bllokim është bërë me arsyetimin se

pallati 9-katësh në ndërtim nuk është me leje. Policia i ka vendosur dje pallatit 9-katësh shiritin e sekuestrimit, ndërsa një efektivi policie e ka marrë atë nën ruatje, duke mos lejuar futjen e askujt. Pallati i bllokuar ndodhet në qendër të qytetit të Lezhës në bulevardin "Gjergj Fishta" dhe është në pronësi të firmës "Boga". Lidhur me këtë rast aktualisht prokuroria


e Lezhës është duke vijuar hetimet për të mësuar përgjegjësit e këtij ndërtimi të paligjshëm. Hetimi është shtrirë dhe tek zyrtarët e bashkisë së Lezhës, të cilët dyshohet se me veprimet dhe mosveprimet e tyre kanë lejuar ndërtimin e këtij objekti pa leje. Pritet që në pyetje për këtë çështje të merren shumë persona, punonjës të bashkisë së Lezhës.

LAJMI

Avokatja e familjes Berisha, nuk është banorë rastësore e kompleksit "Jon" që tashmë diskutohet për tu prishur nga INUK. Erinda Ballanca, ka një lidhje shumë të ngushtë me kompaninë "G.B.A Konstruksion" pasi ka mbrojtur në gjykatë të gjitha proceset gjyqësore të saj.



Në foto: Erinda Ballanca, avokatja e familjes Berisha (djathtë) Faksimile e vendimit të marrë dje në Gjykatën e Vlorës



Berisha: Vendim për tu përshëndetur!

Një vendim për tu përshëndetur. Kështu e ka quajtur ish-kryeministri Sali Berisha, vendimin e gjykatës Administrative në Vlorë, i cili ka lejuar banorët të hyjnë në apartamentet e tyre që kanë blerë në kompleksin "Jon".

TIRANE

ELTON QYNO

Erinda Ballanca mbrojtëse ligjore e "G.B-A Konstruksion"

Avokatja e Berishës mbron pallatin e Bashës Gjirokastra pezullon rrethimin e kompleksit "Jon"

Reagimi


INUK: Është marrë 1625 m2 det më vonë flasim për prishjen

Sipas inspektorëve të INUK një sipërfaqe prej rreth 1625 metra katror është shtuar para pallatit, duke bërë që mbi këtë sipërfaqe të ndërtohet pishina dhe aksesori të tjerë të këtij objekti. Një shifër e tillë ka dalë nga matjet e kryera në teren, prej nga ka rezultuar se administratorët e këtij objekti kanë kryer shtim artificial të tokës dhe këtë gjë e kanë bërë në drejtim të detit. Sipas burimeve të INUK, skandali në fjalë merr përmasa akoma edhe më të mëdha, pasi e gjithë kjo sipërfaqe është hipotekuar nga pronarët e pallatit. Kjo sipas tyre është një shkelje flagrante e zyrtarëve të Hipotekës në Vlorë, të cilët kanë regjistruar një pronë që nuk



Pallati i Bashës në Vlorë

dhe se për rastin në fjalë nuk ka një vendim sekuestro apo prishje dhe se çështja është ende në verifikim e sipër. Pas kësaj, gjyqtari Astrit Shema, është tërhequr për vendim, ku



Faksimile e vendimit të Gjykatës ku tregohet Erinda Ballanca duke mbrojtur shoqërinë "G.B-A Konstruksion" që ndërtoi kompleksin "Jon" në Vlorë

VENDIMI I GJYKATËS

Në vendim thuhet: "Marjen e masës provizore të sigurimit të kërkesë padisë duke pezulluar kryerjen e veprimeve administrative nga çdo subjekt i administratës së shtetit që pengojnë kërkesit në gëzimin e qetë të pronës së tyre në objektin e ndodhur në zonën e Ujit të Ptohtë në truallin me pasurinë 16/8 regjistër hipotekor 426 datë 19.11.2009 me sipërfaqe trualli 1663 metër

katror në pronësi të pronarëve të truallit Xhuvë Sharxhi dhe Xhafer Isufi regjistruar në regjistrin hipotekor, masë kjo e cila do të qëndrojë në fuqi deri në zgjidhjen në themel të konfliktit. Nëse kërkesit paraqiten në gjykatë brenda afatit 10 ditor nga dhënia e kësaj mase provizore, padinë e themel në lidhje me kundërshtimin e veprimeve apo të aktit administrativ që do të dalë në lidhje me këtë objekt prone e kërkuarave.

NGA SALI BERISHA

Te dashur miq, sot Gjykata Administrative e Vlores vendosi heqjen e shtetrrrethimit bandedes tek urdheruar nga Edi Rama dhe kontrollit Orwellian te identitetit te pronareve me leter-njoftim dhe certifikate pronesie per te hyre ne apartamentet e tyre. Ne vendimet e saj Gjykata njohu faktin se institucionet e administrates shtetore kane vepruar ne tejkallim te kompetenceve te tyre duke qene se nuk kane dale me nje akt dhe se nga veprimet e tyre cenohet dukshem parimi i ligjshmerise dhe i proporcionalitetit te veprimitarise se administrates shtetore.

Gjykata deklaroi se te drejtat e qytetarëve dhe e drejta e tyre për gëzuar te qete pronen jane te drejta kushtetuese te pacenueshme! Ajo vendosi pezullimin e veprimeve administrative te bera nga INUK-u vendor e qendror dhe Policia ne pronen prej 1663 m2.

Kështu u pershendes ketë vendim te rendesishem per cdo shqiptar sepse shiriti i zones se krimit qe kishte rrethuar shtepite e blera dhe hipotekuar sipas rregullit dhe ligjit kishte rrethuar ne fakt dukshem - padukshem shtepine e cdo shqiptari. Sot ne Vlore, ne betejën midis shtetit policor dhe shtetit ligjor, midis antiligjit dhe ligjit, fitoi ligji dhe shteti ligjor, e drejta dhe Kushtetuta e vendit! sb

Postuar në Facebook në orën 7:20 pm, 7 nëntor 2013

PERPLASJET NE PARLAMENT



Kuvendi miratoi me 73 vota pro, dhe 1 kundër për ngritjen e nënkomisjonit "Për Qeverisjen Vendore" me kryetar Bashkim Fino dhe 74 vota pro, asnjë kundër, të nënkomisjonit "Për të drejtat e njeriut" në përbërje të Komisionit të Ligjeve me kryetare Vasilika Hysin. Ndërkaq, me 72 vota pro dhe 1 kundër (Saimiri Tahiri), Kuvendi miratoi ndryshimet e

Vendimet në Kuvend, vetëm me votën e mazhorancës

kërkuara nga grupi i PD-së për përbërjen e komisioneve parlamentare. Arben Ristani nga Komisioni i Integritimit do të shkojë tek Siguria, deputeti Bogdani nga Integritimi tek i Jashtëm dhe deputeti Imami nga Komisioni i Jashtëm tek i Integritimit. Me 74 vota pro u vendos shqyrtimi nga ana e Kuvendit me procedurë të përshpejtuar e kontratës me "Crown Agents".

Kartmonedha me fytyrën e Ramës në sallë. Meta: Veprim i padenjë Opozita "lekë" në Kuvend bojkoton seancën plenare Socialisti Fino "kundër" qeverisë për transportin e deputetëve

LAJMI

Deputetët e opozitës mbushën dje sallën e Parlamentit me kartmonedha me fytyrën e kryeministrit, kjo në kuadër të protestës për zgjedhjet në Korçë. Ndërkohë që më pas gjatë votimit, deputetët e opozitës bojkotuan votimin e projektligjeve.

TIRANE

ARTEMISA HOXHA

Në shenjë proteste ndaj zgjedhjeve të mbajtura në Korçë duke i referuar disa pamjeve filmike, deputetët e opozitës mbushën dje sallën e Parlamentit me kartmonedha 20-mijë lekëshe të printuara me fytyrën e kryeministrit Rama, të cilat i hodhën që në fillim të seancës në drejtim të rreshtit të kabinetit qeveritar. Këtë gjest e bëri i pari, kreu i grupit parlamentar të PD, Edi Paloka, i cili në përfundim të fjalës së tij lëshoi në drejtim të kryeministrit Rama kartmonedha 20-mijëlekëshe, në të cilat shkruhej fraza "Unë

Olldashi

Olldashi ndryshe nga grupi

Sokol Olldashi ishte i shteti deputet, i cili nuk lëshoi kartmonedha në drejtim të kabinetit qeveritar pas fjalimit të tij, por dhe që vjedhjen e votave e cilësoi si një fenomen që ka prekur të gjitha partitë. "Sigurisht që ju e keni fajin për atë që keni bërë në Korçë. Sigurisht që kemi ne faj që kemi bërë sikur nuk e kemi parë këtë fenomen, kur e bënim partitë në koalicion me ne dhe kjo nuk është demokracia për të cilën kanë nevojë shqiptarët?", tha ai.

besoj në blerjen e votës". Ky gjest më pas u ndoq nga të gjithë deputetët e opozitës.



Kartmonedha 20 mijë lekëshe në shenjë proteste

I menjëhershëm ka qenë reagimi i kryetarit të Kuvendit Ilir Meta, i cili e ka cilësuar sjelljen e deputetëve si jo etike dhe krejtësisht të padenjë. "Veprime të tilla nuk kanë asnjë lidhje me etikën që duhet të tregojmë. Kjo sjellje për mendimin tim është krejtësisht e pavend dhe e padenjë", u shpreh Meta. Ndërkohë që edhe në ambientet e jashtme të Kuvendit, të rinjtë e FRPD u shpërndanë kartmonedha

deputetëve të mazhorancës, të cilët me të qeshur nuk refuzuan të pranonin.

QËNDRIMI KUNDËR

Pas debateve mes palëve lidhur me zgjedhjet e Korçës, kreu i Kuvendit hodhi në votim projektligjet që ishin në rendin e ditës. Deputeti Bashkim Fino ashtu si në Komisionin e Ligjeve votoi kundër projektligjit të qeverisë ul të shpenzimit e

AKUZA

"Po atë ministrin pse e mbajnë fshehur, atë ministrin që nuk ka paguar fatoren! 45 milionë lekë në telefon?! Ku është ai? Pse fshihet?! Pse nuk vjen në Kuvend. I kërkoj KLSH t'i hedhë një sy faturave të telefonit të këtij ish-ministri, që ndër numrat me të cilët kish folur kishte edhe një numër hotline me 0900, por jo këtu por në Gjermani. Se kur shkoni nëpër hotele në Gjermani me shërbim nga shteti, harxhoni telefon me numrat 0900".

zyrtarëve. Gjatë votimit, ndryshimet morën 71 vota pro, 1 kundër, ndërsa opozita u largua nga seanca plenare. Deputeti Fino propozoi fillimisht që të hiqej plotësisht bonusi për transport për zyrtarët, por një gjë e tillë nuk u pranua nga deputetët. Më pas u miratua varianti i qeverisë. Projektligji në fjalë, parashikon ofrimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë duke shfrytëzuar mjete në dispozicion të institucioneve, si dhe reduktimin e kostos financiare



që mbart zbatimin e ligjit aktual në fuqi. Në qëndrimin e tyre, deputetët e opozitës, deklaruan se projektligji i propozuar nga qeveria nuk do të sjellë kursim por rritje të shpenzimeve. Kryetari i Grupit Parlamentar të PD, Edi Paloka deklaroi se me këtë projektligj, qeveria po vazhdon të mashtrojë shqiptarët. Nga ana e tyre, anëtarët e mazhorancës vlerësuan se ky projektligj synon heqjen e abuzivizmit dhe privilegjeve për funksionarët e lartë të shtetit. Ministri i Financave, Shkëlqim Cani bëri të ditur se vlera që kursehet falë kësaj ndërhyrjeje është 165 milionë lekë ndërsa theksoi se ndryshimet në ligj ulin numrin e funksionarëve që përfitojnë bonuse për transport në 437 persona nga 624 persona që e përfitonin këtë privilegj më parë.

Replikat dhe batutat

Makinat, Sterkaj-Metës: Merrni masa të mos gjobitemi

Paloka: Patë një kryeministër të papërgjegjshëm që gjërat më të rëndësishme të këtij vendi i merr me të qeshur. Ajo që ndodhi në Korçë është një sinjal alarmi për të gjithë, ato pamje filmike thjesht konfirmuan se kemi të bëjmë me një sistem të ngritur deri në detaj për blerjen e votës. Ky është fundi i demokracisë, alarm për të ardhmen.

Topalli: Në 23 qershor trafikantë vrasës dhe horra u bënë të gjithë bashkë kundra Sali Berishës. Kur vjedhjen e votës e quan vërtet pastaj rreziku është fatal. Kur zgërdhiet edhe kryeministri, të dashur shqiptarë bëhuni gati.

Brace: Po kush je ti moj që na flet kështu....?!

Topalli: Sot në Kuvend kanë hyrë "trimat" e bosët e parave e ato bëjnë shumicën! Disa nga këto nuk kanë as shkollë, por kanë diploma se edhe ato i kanë blerë, siç kanë blerë vendin në listën e deputetëve, e pastaj siç kanë blerë votat, e pastaj siç blejnë e shesin kallëp deputetin!! Por Kryeministri 2000 lekësh nuk flet vetëm gjuhën e të korruptuarit! Ai replikon dhe me etërit e 1945 po të mundit! E jo vetëm me dinamit e lëndë plasëse, jo vetëm me bllokime, shfuqizime, shkrirje, zhbërje, jo vetëm me sekuestre dhe sparamite! Të gjithë i

duket se po e tradhtojnë! Këtyj nuk i qesh buza!

Ahmetaj: Ju ishit një mazhorancë e kalbur, tashmë një opozitë e çoroditur. 165 milion lekët do të shkojnë për pensionistët.

Bode: Kleptokracia nuk është demokraci. Ju bazoheni në një pushtet kleptokrat dhe për ju i rëndësishëm është vetëm pushteti juaj. Kleptokracia është tirani e një shumice të blerë. Ju vodhët dhe blët votat në Korçë edhe pse ishte e panevojshme.

Peleshi: Zgjedhjet në Korçë kanë qenë më të mirat dhe më të ndershtmet.

Bregu: Të gjithë i pamë se si ishin. Mos u bëj hipokrit tani.

Peleshi: Rezultati ishte 76% për kandidatin tonë. Ju mund të jeni opozita e vetme në planin që nuk dini të numëroni votën.

Noka: Prandaj nxorret 20 mijë lekshat ju...

Rama: Me siguri nga lartësia e kompetencës si deputet i vjetër ka një arsye që e thotë,



ndërsa përsa më takon si deputet i ri, me siguri jam dakord me deputetin e vjetër, që kjo është vërtet seanca më e pëshitur dhe më e turpshme, që unë këtu kam asistuar, megjithëse kam parë të tjera ende më të pëshitura dhe më të turpshme, nga televizori.

Bode: Kryekleptokrati foli tamam në origjinën dhe fytyrën e tij. Së pari u tregua cinik dhe i pashpirt me humbjen e jetës së të rinjve në minierën e Pogradecit. Sepse është detyra →

PERPLASJET NE PARLAMENT

Gjatë fjalës së tij, deputeti i PS, Taulant Balla zbardhi edhe një tjetër akuzë ndaj qeverisë së djathtë dhe më konkretisht ndaj ish-kryeparlamentares Topalli në lidhje me shitjen e 100 makinave të deputetëve. "Duhet të marrim një vendim dhe të hedhim një sy dhe të kontrollojmë se si u shitën 100 makina të deputetëve në vitin 2009, me vlera kre-

Balla: Topalli të hetohet, shiti 100 makinat e deputetëve

jtësisht qesharake. Nuk kam as një inat personal, sepse nuk isha unë një ndër blerësit e atyre makinave, pavarësisht se shiti dhe makinën që më takonte mua. Makinën që unë si deputet i Librazhdit përdorja Xhozefina ia shiti Pashukut të radhës me një çmim qesharak, 2 milionë lekë të vjetra. Xhozefina Topalli duhet hetuar edhe për këtë", tha Balla.



NË FOTO: Edi Paloka duke hedhur kartmonedhat nparlament

Kuvend, kryeministri-Bodes: Kryellogaritar i keqqeverisjes

Rama: Jeni të lirë të hetoni për Korçën

Bode: Kthyet 'Republikën e 20-mijë lekshave'

TIRANE ARTEMISA HOXHA

Akuzat e opozitës në Kuvend në lidhje me zgjedhjet në Korçë, shërbyen si indicie e debateve të gjata seancën e djeshme parlamentare. Në reagimin e tij në lidhje me këto akuzat, kryeministri Edi Rama i bëri thirrje opozitës të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për të vërtetuar nëse ka shkelje me votat në Korçë. Ai i ka kërkuar opozitës madje që të ndjekë rrugët juridike e kushtetuese për të faktuar pamjet e emisionit investigativ. "Unë jam deputet i ri dhe më bëri përshtypje ajo që tha deputeti i vjetër që sipas tij kjo është seanca më e pëshitur dhe më e turpshme e kësaj salle. Nuk është as e diskutueshme as e negociueshme dhe keni gjithë të drejtën e Zotit që interpretimin tuaj ta verifikoni në të gjitha rrugët që ju i konsideroni të drejta dhe që Kushtetuta ia njeh, jo një opozite të tërë por dhe një individ të vetëm, që të kërkojë të drejtën e tij", tha Rama. Këtë qëndrim kryeministri e mbajti pas fjalimit të deputetit të PD, Sokol Olldashit, i cili akuzoi qeverinë si dhe



Kryeministri Edi Rama në sallën e parlamentit

PRESIONI

Qeveria në largim ka zgjedhur presionin e gjithanshëm ndaj Policisë së Burgjeve me anë të "mashës" me nr.20 që mban në mënyrë të paligjshme. "2 kunguj nën nguj nën një sgetull ngujën në mënyrë të paligjshme, "2 kunguj nën nguj nën një sgetull ngujën njëës të paligjshme, "2 kunguj nën nguj nën një

kërkoj ndërprejen e seancës, duke u fokusuar vetëm te diskutimi për zgjedhjet në Korçë. Ndërkohë që duke u ndalur te projektligji "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë", Rama tha se këto të ardhura që do të mblidhen do të shërbejnë vetëm për pensionet dhe për njerëzit me ndihmë sociale. Replikat vijuan edhe me ish-ministrin e Financave, Ridvan Bode, i cili e akuzoi kryeministrin Rama

se po merr borxh për lukse dhe jo nevojat e shqiptarëve. Sipas tij, kjo është një republikë ku maxhoranca formohet përmes blerjes së votave, një "Republikë e 20 mijë lekshave, ne jetojmë nën qeverisjen e atij, që 20% e ngriti në institucion". Sipas Bodes, "vullneti i kleptokratëve mbyll biznese të licencuara, legjitime, pa ligj prish ndërtime me leje, pa ligj anulon kontratat të ligjshme, pa ligj largon administratën publike nga puna, pa ligj dhe

procedura ligjore anulon ligje tashmë në fuqi, të miratuara me konsensus. I menjëherëshëm ka qenë reagimi i kryeministrit, që e cilësoi Bodein si kryellogaritar të keqqeverisjes që mbante vetëm lapsin, ndërkohë që dorën ia tundte ai që priste shiritat. "E vërteta nuk është thjesht që zotrote tallësh me shqiptarët, por kjo që zotrote ke bërë 8 vjet me radhë, lapsin mbaje, dorën ta tundte dikush tjetër, planifikojë sikur do mblidhje paratë e Ballkanit dhe shkojë që në janar rishikojë buxhetin, duke zhytur në borxh shqiptarët për të prerë shiritat e inaugurimeve të atij që të tundte dorën", tha Rama.

Punësimet

Kryeministria, konkurse për vendet vakante

Qeveria shqiptare shpall konkurset për vendet e lira të punës në njësitë e kryeministrit. Zëvendëskryeministri Niko Peleshi ftoi të interesuarit që e ndjejnë veten të aftë e të talentuar të bëhen pjesë e këtyre konkurseve. "Për herë të parë në Shqipëri, ne do synojmë praktika të rekrutimit të jenë të ndryshme nga ato tradicionale. Për herë të parë në Shqipëri rekrutimi do kryhet nga qendrat e vlerësimit. Qendrat e vlerësimit janë ato qendra të cilat mundësojnë meritokracinë të vijë në vendin e punës. Pra praktikata e reja të rekrutimit janë ato që të udhëheqin këtë proces të rekrutimit të profesionistëve të spikatur të studiuar në Shqipëri apo jashtë vendit, të kualifikuar, të talentuar apo ekselentë. Qëllimi i këtyre konkurseve do jetë tëpër i qartë, kryeministria do jetë qendra e ekselencës të administratës Shqiptare.", tha ai.

jote që atë minierë që është në atë konservim ta ruash, paguhen rreth 15 veta që duhet ta ruajnë atë minierë që të mos futen njerëz sepse është e rrezikshme.

Rama: Ne besojmë që në një vend si Shqipëria kryeministri nuk mund të udhëtojë në biznes klas dhe delegacionet qeveritare nuk mund të jenë të panumërta me sojë edhe sorrollop për të shkuar me demok për të përfaqësuar shtetin dhe pastaj për t'u turmur të gjithë për shoopng. E sa për "Fiks Fare"-n, tani që kemi ngrirë të gjithë, ju mbetet vetëm të shkruini Filipin.

Ristani: Kjo është një shashkë në tym për të krijuar një mjegull të madhe. Mjegull e cila do t'i shërbejë ujçërve. Një genie e vetëdijshme po e hante ujku dhe qenia po mendonte ishalla jan më ëndërr. Këta lloj ujçërish këtë lloj mjegulle duan, pikërisht se janë të pabesë si ujç. Cështja është mos u gëzoni se ujku po ha delet e komshiut se shumë shpejt do

të vijë në bahçen tuaj.

Balla: Deputeti që sapo foli ishte në gradën e fundit, pas dopios së shtatë të ëhisky-t, ka bërë pis dhe foltoren. Duhet të jetë në normën e këtij Kuvendi që deputetë të pirë dhe në gjendje të rëndë alkoholike të mos lejojnë të hyjnë në Kuvend. Këta që hodhën sot para të printuar me shumë para të tjera të harxhuara kot nuk e njohin lekun fare. 3000 euro e shiste Jozefina Topalli bashkë me Arencën një vend pune mësues në Shkodër. 5000 euro e shiste një vend pune në polici Jozefina bashkë me Arencën në Shkodër. Sot derdhte lot krokodili.

Sterka: Problemi është tek puna e parkimit të deputetëve, prandaj ju si kryetar, bashkë me byronë, duhet të merrni masat e duhura që të mos gjobitemi nga policia. Ne nuk duam që të shkelim ligjin, është detyrë, prandaj duhet të merrni masat që të mos gjobitemi.

SOCIETE GENERALE ALBANIA

Request for proposal GRD-RFP-2013-023 For: "Cleaning Services for Bank's premises and Purchase of Cleaning Materials"

Societe Generale Albania Bank invites proposals from eligible and qualified companies for:

1- Cleaning Services for Bank's premises and Purchase of Cleaning Materials.

The complete Request for Proposal Documents is available for download at Societe Generale Albania Bank's website www.societegenerale.al/ Tenders section, or upon request to: procurement.al@socgen.com.

Proposal must be delivered on or before **November 22nd 2013, 12:00 hrs (CET)** in a sealed envelope marked with:

Banka Societe Generale Albania
General Resources Department
Blv. Deshmoret e Kombit
Twin Towers, Tower 1, 9th floor
Tirana, Albania

To the attention of: **Mr. Ilir Apostoli**
Head of Procurement Sector

Name of the bidding service provider

Proposals sent by fax or email will not be accepted.



Korçë, KQZ pa vendim, shkak mungesë kuorumi

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka mundur të marr vendim për të pranuar apo jo kërkesën ankimore të Partisë Demokratike për anulimin e zgjedhjeve e pjeshme për kryetar bashkie të zhvilluara në Korçë më 3 nëntor 2013. Dje, trupa e KQZ-së nuk ka arritur të marr një vendim për shkak të mungesës së kuorumit. Duke j'u referuar vendimit të Kolegjit Zgjedhor të cilën e quajti pavlefshëmri absopute

vendimin që kishte marrë KQZ-ja për ndarjen e mandateve për qarkun e Lezhës që e kishte miratuar me katër vota. E vendosur përpara këtij precedenti, KQZ doli pa marrë asnjë vendim. Vetë relatorja e çështjes, Vera Shtjefni ka deklaruar se ankimimi i Partisë Demokratike i plotëson kërkesat e ligjit. Por sipas saj, KQZ-ja nuk mund ta marrë në shqyrtim ankimimin e PD, pasi është numri i nevojshëm i anëtarëve për të marrë vendim.

Po kjo sigurisht që është kundërshtuar nga përfaqësuesi i Partisë Demokratike Njazi Kosovrasti, i cili ka kërkuar që KQZ ta pranojë, me pretendimin se mund të ketë mundësi shqyrtimi, pasi Parlamenti mund të plotësojë vakancat në KQZ-së. "Opozita po kërkon majën e ajsbergut, por nuk do gjejë asgjë pasi kemi paguar vetëm biletat e udhëtimit për studentët", tha Salianji, përfaqësuesi i PS-së në KQZ.

Bashkë me PD në protestë do dalin dhe PR, PDIU, LZHK dhe PDK

"Korça" ribashkon opozitën të hënën të gjithë në shesh

Paloka: Tubim para kryeministrit kundër blerjes së votës

LAJMI

Aleatët e PD-së kanë dhënë dakordësinë për të marrë pjesë në protestën simbolike të organizuar nga e djathta. Në një takim që Basha pati me aleatët i ka njoftuar ata për aksionin politik, duke ju kërkuar që të organizojnë mbështetësit e tyre për të ardhur në Tiranë.

TIRANE
FERNADA GENKO

PYETJE PERGJIGJE

■ Çfarë ndodhi në Korçë pas përfundimit të procesit zgjedhor?
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpalli rezultatin e zgjedhjeve në Korçë ku fitues doli kandidatura e zgjedhur nga Partia Socialiste Sotirag Filo me më shumë se 10.000 vota në favor, krahasuar me kandidatin Sotirag Strtoberdha, nën logon e Partisë Demokratike.

■ Çfarë ndodhi më pas?
Menjëherë atë ditë (ditën e hënë) emisioni Fiks Fare në televizionin Top-Channel ka shfaqur një video ku disa të rinj (përfshirë edhe gazetaren e "Fiks Fare" kanë shkuar për të marrë lekët, që sipas tyre ishte "gjoba" e votimit për kandidatin Sotirag Filo.

■ Po pas publikimit?
U mjaftua kjo video që PD në orën 21:30, nëpërmjet deputeti Eduard Halimi të dilnin në një konferencë për shtyp dhe të kërkonin përsëritje të zgjedhjeve. Vetëm një ditë më vonë kjo forcë politike dërgoi në KQZ kërkesën ankimore, dhe paralelisht me këtë paralajmëroi ngritjen e komisionit hetimor.

■ Çdo ndodh të hënën?
Të hënën PD se bashku me aleatët do dalin në një protestë simbolike përpara Kryeministrit për t'i thënë "jo" votës së blerë.

Kreu i Partisë Demokratike Lulzim Basha ka mbledhur dje kryetarët e partive që janë në koalicion me PD, për t'ju bërë të ditur aksionin politik që do të zhvillojnë për blerjen e zgjedhjeve në Korçë nga PS. Dje, në orën 9:30, Basha ka thirrur kreun e PDK-së, Nard Ndoka, kreun e PDIU-s Shpëtim Idrizi kreun e PR-së, Fatmir Mediu si dhe kreun e LZHK, deputetin e dalë nga listat e PD, Dashamir Shehin, ku ka paraqitur vendimin e PD për të thelluar aksionin politik nëpërmjet një proteste paqësore që do mbahet ditën e hënë, përballë Kryeministrit. Të gjithë aleatët i kanë dhënë "ok" pjesëmarrjes së tyre. Burime brenda takimit pohojnë se aleatët do të sjellin edhe mbështetësit e tyre nga e gjithë Shqipëria me makina që do të vihen në dispozicion nga vetë forcat politike.

MBLIDHET KRYESIA
Lulzim Basha ka ngarkuar të gjithë deputetët për të mbledhur degët e Partisë Demokratike në rrethe për të mobilizuar të gjithë mbështetësit e së djathtës për të marrë pjesë në protestën simbolike që do të organizohet ditën e hënë përpara Kryeministrit si një kundërshtim ndaj gjestit të blerjes së votave në qytetin e Korçës nga PS. Megjithatë dje pasdrekë të gjithë kryetarët e partive në rrethe kanë marrë një sms nga selia qendrore e PD ku ka ftuar

të gjithë mbështetësit e PD që të marrin pjesë në protestën që do të zhvillohet në orën 14:00 përpara Kryeministrit. Të gjitha shpenzimet do të mbulojnë nga PD e rrethit

REAGIMI I PALOKËS
Deputeti i PD-së Edi Paloka



Kryetari i Grupit Parlamentar të PD, Edi Paloka

PDK ndryshon qëndrimin

Ndoka mbështetësi i Filos, tani në protestë për blerjen e votës

Edhe pse Nard Ndoka, deputeti dhe Kreu i Partisë Demokratike kishte paktin për të mbështetur kandidaturën e Partisë Socialiste Sotirag Filo në zgjedhjet e pjeshme të Korçës, ai është i pari që do të dalë në protestën që do ta organizojë Partia Demokratike kundër blerjes së votës ditën e hënë përpara Kryeministrit. I pyetur nga gazeta "Shqiptarja.com" mbi vendimin që ka marrë nëse do të jetë pjesëmarrës në këtë protestë apo jo Ndoka tha se: "Absolutisht që do të jem një ndër të parët që do të marrë pjesë në këtë protestë. Edhe pse partia ime e ka mbështetur kandidaturën e Sotirag Filos, kjo nuk do të thotë që unë të hesht përpara gjithë asaj video që tha me zë edhe me figurë se si u blenë votat në Korçë. Unë për mbrojtjen e votës kam mbështetur edhe Partinë Socialiste, e cila ngrihet në protestë. Po ndodh e njëjta gjë, edhe këtu po fillim



për blerje të votës, duke nxitur qytetarët me mjete jo demokratike për të votuar për një forcë politike të caktuar, apo në këtë rast për një kandidat për kryetar bashkie", është shprehur kreu i PDK-së, Nard Ndoka. Kreu i PDK-së mbështeti kandidatin e PS në Korçë pasi ishte pakti që ai kishte nënshkruar me PS në zgjedhjet vendore të 2011. Për ti qëndruar këtij pakti, edhe pse ai është një tjetër kamp politik, Ndoka ishte si pjesë e koalicionit me PS-në.

ka i ka bërë thirrje qytetarëve të reagojnë për aktin e blerjes së votës, duke ju bashkuar protestës që do të zhvillohet ditën e hënë. "Ajo që ka ndodhur në Korçë është një sinjal alarmi për të gjithë, ne e thamë, nuk është se është diçka që nuk dihet, por

tashmë u pa nga të gjithë. Ky është fundi i demokracisë, fundi i pluralizmit. Të hënën ne do të kemi një protestë simbol para kryeministrit për këtë akt të rëndë, më tepër thirrje ndaj qytetarëve që të reagojnë për këtë akt të rëndë. Është për të ardh-

men tonë, nuk është shaka e Ramës, nuk është për t'u zgërdhirë". Sipas tij, ky aksion politik nuk do ta demontojë mundësinë për marrjen e statusit të vendit kandidat për në BE, ndërsa i kërkon ndërkombe të mos ndikohen nga kjo situatë.

Itinerari

Mbështetësit e PD, PDIU, PR, PDK do të grumbullohen përpara selisë blu në orën 14:00, tek ish Shtëpia e Ushtrakeve dhe do të marrshojnë drejt Kryeministrit aty ku pritet që të qëndrojnë për një kohë të papërcaktuar

NË FOTO: Kryetari i PD Lulzim Basha dhe kreun i PR Fatmir Mediu



VIZITA



Fyle vjen në Tiranë, PD në demonstratë

Edhe pse ditën e hënë mbërrin në Tiranë Komisioneri për Zgjerim Stefan Fyle, Partia Demokratike është e vendosur që në këtë ditë të protestojë kundër "blerjes së votës". Për t'i dhënë edhe më shumë peshë këtij akti, PD e ka zgjedhur jo qëllimisht ditën e hënë. Pasi ashtu siç e dimë edhe nga protestat dhe mitingjet e zhvilluara më parë nga forcat politike, zakonisht ditët më të përshatshme kanë qenë fundjava, kur edhe mbështetësit nuk kanë impemjenie pune. Por kjo duket që është bërë pikërisht për të rënë në sy të ndërkombe të reja. Fyja vjen për herë të dytë brenda një muaji në Shqipëri për të zhvilluar takime në emër të integritimit, pasi në muajin dhjetor pritet të merret edhe statusi i vendit kandidat.



Gjoshja: Statusi në dhjetor hap përpara jo finalizim i procesit

Ministria e Integrimit Evropian, Klajda Gjoshja, priti dje në takim delegacionin COËEB (Grupi i punës i BE, për rajonin e Ballkanit Perëndimor). Ky grup është përgjegjës për çështjet lidhur me marrëdhëniet e BE-së me rajonin e Ballkanit Perëndimor ku bëjnë pjesë Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Serbia e Kosova. Delegacioni do të bëjë gjithashtu një raport vlerësues për Shqipërinë

dhe ky takim i paraprind atij të muajit dhjetor kur do të merret vendimi për marrjen e statusit të vendit kandidat. Gjoshja, theksoi se takimi vjen në një moment shumë të rëndësishëm për integrimin e Shqipërisë në BE. Ajo i vuri në dispozicion delegacionit planin konkret të masave që po ndërmerren nga qeveria. Ajo e njohu delegacionin me disa prej vlerësimeve kryesore të Progres-Raportit që KE, publikoi në tetor, kur u rekomandua dhënia e statusit

të vendit kandidat për Shqipërinë në muajin dhjetor. "Pavarësisht këtij progresi i bazuar në atë çka Komisioni rekomandon për Këshilli e Ministrave të BE, për t'i dhënë Shqipërisë statusin e vendit kandidat, ne jemi plotësisht të ndërgjegjshëm se sfidat në vazhdim janë më të mëdha, sidomos për 5 prioritetet kyçe të identifikuar në Progres Raport, për të vijuar me hapin tjetër të hapjes së negociatave", tha Gjoshja.



Nënkryetarja e PD në grup: Ka vetëm reagime të vakëta Topalli-Bashës: S'jeni i aftë të bëni opozitë

"Kështu, Hakmarrja për Drejtësi do jetë këtu"

TIRANE

JAKIN MARENA



LAJME SHKURT

Integrimi, Bushati raporton sot në Kuvend për procesin

Ministri i Punëve të Jashtme, Ditmir Bushati pritet të raportojë sot në Kuvend në lidhje me integrimin e vendit në BE. Do të jetë një seancë dëgjimore që do të mbahet te Komisioni i Jashtëm, ku Bushati do të jetë i fuar për të rielatuar lidhur me aspektin politik në dinamikën e procesit të Integrimit Evropian të Shqipërisë dhe marrjen e statusit të vendit kandidat. Ndërkohë që Bushati ka siguruar përmbushjen e reformave të duhura që do të çojnë në marrjen e statusit të vendit kandidat në Dhjetor. Këtë premtime, Ministri Bushati e ka bërë në takimin me Komisionerën e BE për Çështjet e Ditet e Peshkimit, Maria Damnani.

PRECEDENTËT

Debatet në PD kanë vijuar që me startimin e Kuvendit të ri, ku pas tetë vitesh, PD dhe aleatët e saj janë në opozitë, përballë një mazhorance me 85 vota tashmë. Bojkoti i seancave kuvendore erdhi si reagim ndaj Aktit Normativ të qeverisë për ligjin e Administratës Publike. Ka qënë deputetja Mesila Doda ajo që i është kundërvënë liderit demokrat Lulzim Basha, duke kërkuar që opozita të bëhet në Kuvend e jo jashtë tij, pasi kishin kritikuar dikur PS.

në pushtet". Më tej mësohet se Topalli ka akuzuar Bashën se "je i paaftë të udhëheqësh PD dhe opozitën për të arritur grumbullimin e njerëzve rreth PD". Deklarata këto që nuk kanë marrë asnjë lloj reagimi

"Situata ka qënë e tensionuar në mbledhjen e grupit të PD, të thirrur jashtë radhe për të përcaktuar dhe qëndrimin politik pas "kauzës" së papritur që doli për opozitën"

nga ana e kreut të PD Basha, por as nga drejtuesit e grupit parlamentar dhe deputetët e thjeshtë, gjë që ka sjellë dhe deklarata të tjera të Topallit në drejtim të lidhshimit të ri të partisë, teksa ka kujtuar se në

këtë mënyrë do të qëndrohet gjatë në opozitë e se një video nuk mund të përbëjë kauzë për opozitën, që duhet të gjejë një kauzë të vërtetë për të qënë e besueshme dhe e aftë të përballojë këtë mazhorancë. Mësohet se Topalli ka thënë se "me këtë lloj opozitarizmi, po na vjen këtu Hakmarrja për Drejtësi, të cilën do ta kemi nëpër këmbë. Nuk përbën kauzë për opozitën video me atë që ka ndodhur në Korçë. Duhet ta pranojmë, humbja ishte shumë e thellë, dhe nuk ka asnjë argument anësor për këtë". Ndërkohë që ky debat ka ndodhur ditën e martë në mbledhjen e grupit parlamentar vetëm dy ditë më pas demokratët e kanë ashpërsuar gjuhën ndaj mazhorancës së majtë për çështjen e zgjedhjeve në Korçë, teksa kanë paralajmëruar protestë në fillim të javës së ardhshme, e cila do të vijojë përhapjen në të gjithë vendin, përballë kryeministrit dhe institucioneve të tjera.



PD ka të paktën 8 vjet që është përzënë nga Korça

Nënkryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste Erjon Braçe pas debateve në Kuvend në lidhje me zgjedhjet në bashkinë e Korçës është shprehur se Korça tetë vite që e ka përzënë PD.

NGA ERJON BRAÇE

PD ka të paktën 8 vjet që është përzënë nga Korça!! Korçarët e munden në 2005 në qytetin e Korcës! Korçarët e munden në 2007 në qytetin e Korcës! (ishite PD në pushtet). Korçarët e munden në 2009 në qytetin e Korcës! (ishite PD në pushtet). Korçarët e munden në 2011 në qytetin e Korcës! (ishite PD në pushtet). Korçarët e munden në 2013 në qytetin e Korcës! (ishite PD në pushtet). Madje madje Korça e mundi personalisht Sali Berishën edhe në vitin 1994, kur me Referendum donte të vetshpallej Mbret!!

Atë kohe, Sali Berisha tha: KUR TE DO KORÇA TE DO BOTA!! KORÇA I KTHEU PËR GJIGJE: NUK TE DUAM!! Prej asaj kohe kështu ka mbetur. Nuk ju do Korça! Sepse Korça ka lindur prej kultures! Ju lindet mu në mes të rruges! Ulerini! Shani! Mallkoni! Sulmoni! Dhunoni! Vidhni! Beni pis! KJO KULTURE NUK ESHTË E KORCES!

SA HERË TI VINI NDESH KESAJ KULTURE JU VETEM DO TE HUMB! NUK DO TE GJENI VEND NE KORCE! Pertej kesaj, qasja jone eshte krejt tjeter; TE HETOHET CDO GJE! PS NUK FSHIHET E AS FSHEH GJE. PO BASHKEPUNON ME PROKURORINE DHE NUK PO I FSHEH GJE PREJ GJEJE!

AS PO E SULMON E AS PO E DHUNON. Kane lirine te hetojne gjithcka dhe kedol!

Postuar në facebook në orën 21:35, datë 7/11/2013





“Tërmet” në Gardë, ulje në gradë, dorëhiqet Artan Hoxha

Për shkak se s’pranoi uljen në gradë, jep dorëheqjen Ish-shefi i Shtabit të Gardës së Republikës, NënKolonel Artan Hoxha dhe 3 oficerë të lartë, ndërsa 12 të tjerë e pranuan këtë fakt. Hoxha është personi që zëvendësoi Ndreja Prendin, teksa ai kishte procesin e 21 janarit. Aty Hoxha deklaroi se kishin informacion se në demonstratën e vitit 2011, do të sulmohej ish-kryeministri Berisha.

Ndërkaq, Shemsi Premçi është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i Emergjencave Civile, ndërsa Ermir Gjikola emërohet Shefi i Komisarariatit Krujë. Ministria e Brendshme ka vendosur tu heqë gradën 12 oficerëve të Gardës së Republikës së Shqipërisë. Sipas burimeve pranë kësaj ministrie, vendimi është marrë pasi grada që oficerët mbanin u është dhënë në kundërshtim me ligjin.

Ministria e Brendshme bën me dije se janë liruar nga detyra katër oficerë të lartë dhe shefi i Shtabit të Gardës së Republikës, për shkak se gradat nuk ishin në përputhje me ligjin. Nga ana tjetër postin e Drejtorit të Përgjithshëm të Emergjencave Civile e ka mbajtur Alfred Olli, i cili zëvendësohet tashmë nga Premçi. Tahiri, pak ditë më parë ka deklaruar se ka vetëm 5 fadroma.

Paralajmërimi nga Ministria e Brendshme

Policia: Që tani pranga shoferëve pa dokumenta

Dje startoi operacioni, vetëm në Kavajë tetë arreste

LAJMI

Policia e Shtetit arrestoi dje 8 persona në Kavajë, pasi nuk kishin patenta me vete. Nga sot e tutje, policia do të arrestojë çdokënd që drejton një mjet pa lejë drejtimi, duke zbatuar kështu ligjin dhe Kodin Rrugor. Policia tha se aksioni do të vijojë dhe po ushtrohen disa kontrolle

TIRANE
MARIGLEN MULLA



Sokoli. Këta shtetas janë kapur duke drejtuar automjete dhe motorçikleta pa leje drejtimi. Materialet në ngarkim të tyre i janë referuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të

parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Operacioni i djeshëm është ndjekur nga afër nga drejtuesit më të lartë të Drejtorisë së Qarkullimit Rrugor në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

DISIPLINIMI

Si një prej arsyeve më të shumta të aksidenteve në rrugë, përveç dehjes në timon, ka qenë edhe dhënia e mjetit, pa kaluar më parë kurset profesionale. Adoleshentë që ecin në rrugë, pa plotësuar asnjë nga testimet e ekspertëve dhe si pasojë mosnjohja e normave në qarkullim, sipas ekspertëve, përbën një prej problemeve kryesore në qarkullimin rrugor.

të Shqipërisë, ku zhvillohen seancat parlamentare. Policia sqaron se kontrolli po zhvillohet në rrugët kryesore por edhe në tolerohet asnjë shtetas, madje as ndonjë punonjës policie që lëviz pa letra. Sipas policisë, këto masa po ndërmerren për shkak të shtimit të numrit të aksidenteve, por edhe të shtimit të drejtuesve pa patentë. Sipas urdhrit të lëshuar nga Ministria e Brendshme, uniformat blu të Tiranës nuk do të tolerojnë asnjë shtetas apo zyrtar, i cili do të tentojë të parkojë mjetin e tij përballë Kuvendit të Shqipërisë, duke shkelur rregullat e qarkullimit rrugor. Ky urdhrë është pjesë e masave të Ministrisë të Brendshme, Saimir Tahiri, për tolerancë zero ndaj kujtdo që shkel ligjin dhe që tenton të dalë mbi ligjin. Parkimi i makinave përballë Kuvendit të Shqipërisë në shkelje të ligjit, në shumë raste edhe mbi trotuar, përgjatë seancave parlamentare, ka qenë gjithnjë një ngërcë për qarkullimin rrugor.

AKSIONI I GJERË


Policia e Tiranës ka nisur një aksion, për një sërë masash ndaj makinave me targa të huaja, atyre me mungesë dokumentacioni dhe automjetet të cilat do të parkohen në mënyrë të paligjshme përballë Kuvendit

Incidenti në Durrës një rast tjetër në Tiranë

Pezullim 2 policëve, s’ndërhynë në sherr me armë midis djalit e babait

TIRANE

Dy efektivë të policisë rrugore janë pezulluar nga puna pasi nuk kanë ndërhyrë për të shuar një konflikt të armatosur mes të rinjsh, mbrëmjen e djeshme në qytetin e Durrësit, ndërsa një efektiv i 712-ës është proceduar penalisht nga SHKB-ja, për kërcënim. Reagimi i parë nga policia erdhi pasi dy grupe të rinjsh, pas dhunës verbale, janë konfliktuar me armë zjarri rreth orës 19:45 në lagjen nr 4, pranë një supermarketi në Durrës. Dy efektivë të policisë rrugore mendohet se kanë qenë aty pranë dhe nuk kanë ndërhyrë. Efektivë të tjerë të policisë kanë ndërhyrë dhe kanë shoqëruar në komisarariat dy protagonistët e konfliktit si dhe dëshmitarë. Dy punonjësit e policisë rrugore janë pezulluar nga detyra deria sa të sqarohet ngjarja.



Dardan Imeraj banor i lagjes 4 në qytetin bregdetar është përfshirë në një konflikt me shtetasit, Adem Allçi dhe Adi Allçi, babë e bir, të cilët i kishte edhe fqinj. Pasi

kanë debatuar me fjalë dy pjesëtarët e familjes Allçi kanë qëlluar me pistoletë në drejtim të 22-vjeçarit, i cili ndodhej në një lokal aty pranë, por predhat e plumbave nuk kanë prekur shenjëstrën. Ndërkaq, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, dje në mesditë ka filluar procedimin penal në ndaj punonjësit të policisë (Repartit 712, Tiranë), Lazem Shqemza, 42 vjeç, lindur në Shkodër dhe banues në Kamëz. Ndjekja penale në ngarkim të tij, ka filluar sepse pardje në mesditë rreth orës 14.00 dyshohet se në gjëndje të dehur, ka kërcënuar me armë shtetasin A.M., 36 vjeç, banues në Bathore, i cili ka depozituar një kallëzim ndaj punonjësit. Nga burimet e policisë mësohet se po verifikohet vërtetësia ose jo e këtij denoncimi nga ana e qytetarit. Ndërkaq, javët e fundit është shtuar numri i policëve të implikuar në disa ngjarje të rëndë.

LAJME SHKURT

Nga Zvicra vjen ekip i ri policor

Në takimin që Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Artan Didi, pati me homologun zviceran Jean-Luc Vez, u diskutua ngritja në një stad të ri dhe forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit, si në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar, duke ngritur dhe grupe hetimore apo operacionale të përbashkëta, ashtu dhe në drejtim të ofrimit të asistencës teknike dhe trajnimeve për Policinë e Shtetit.

Tri në pranga për grabitje

Policia e Kurbinit, në bashkëpunim me FNSH-në, në Tiranë, në qytetin e Laçit, bëri të mundur kapjen e shtetasit në kërkim Arbër Allu, 20 vjeç, pasi në fshatin Bërxullë të Tiranës, në bashkëpunim me tre persona, kanë vjedhur banesën e një shtetasi, ku kanë përdorur armë. U kap edhe Edison Çobaj, 18 vjeç dhe Ergys Dushkaj, 27 vjeç, të dy banues në fshatin Balldre të Lezhës. Arrestimi i tyre u bë sepse janë autorë të vjedhjes së banesës së shtetasit L.I.Gj, në Balldre.

Kapen disa lojëra fati

Në kuadër operacionit “Fund Marrëzisë”, përgjatë ditës së djeshme janë referuar materialet në Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për 2 shtetas. U procedua penalisht, në hezim të lirë, shtetasi Erald Hysko, 28 vjeç, lindur dhe banues Tiranë, sepse në rrugën “Sali Butka”, u gjetën dhe disa makina elektronike. I proceduar tjetër është Dashamir Mata, 32 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë, sepse në rrugën “Petro Nini Luarasi”, i u gjet një tavolinë pokeri 8 vendeshe.

Dy zjarre pa rrezik në Tiranë

Dy zjarre ranë dje në Tiranë, ku njëri përfshiu disa magazina të “Ura e Beshirit”, në Ndroq të Tiranës. Magazinat i përkasin një firme, e cila merret me importin e banave. Ndërkohë, regjistrorët dëme materiale, por jo në njerëz. Një zjarr tjetër ka rënë një një kancelari, në periferi të Tiranës, ku nuk ka pasur të lënduar.

Aksidenti, një person plagoset

Një person ka mbetur i plagosur rëndë në një aksident automobilistik rreth orës 22:00 të mbrëmjes së djeshme, pranë zonës së “Oxhakut”, në kryeqytet. Makina me targa AA098DT u përplas me një motor pa targa tip ‘Lifan’ ngjyrë e kuqe.



Projektligji

SHPENZIMET Specialistët e Financave kanë ndarë "tortën" e fondeve buxhetore në dispozicion të institucioneve të shtetit për vitin e ardhshëm

Tatimet

BB e FMN "bëjnë" buxhetin e 2014-ës

Përparësi bujqësia, shëndeti e arsimit

LAJMI

Nën vëzhgimin nga afër të specialistëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, ministria e Financave ka përcaktuar objektivat kryesore të buxhetit për vitin e ardhshëm, që do të paraqiten në Kuvend

TIRANE

ILIR SINANAJ

Hartimi i projektligjit për buxhetin e vitit të ardhshëm tashmë po kalon në "sitën" e ndërkombëtarëve, me një asistencë për herë të parë pas shumë viteve. Qeveria Berisha e mënjanoi këtë kontroll nga ekspertët e FMN dhe BB, të cilët kanë këshilluar prej vitesh më parë qeverinë shqiptare që të jetë e kujdesshme në menaxhimin e financave publike, por edhe në



hartimin e një buxheti sa më realist. Mësohet se tashmë janë përcaktuar prioritetet

OBJEKTIVAT

Edhe pse ka pak ditë që specialistët të Ministrisë së Financave kanë nisur punën për hartimin e projekt-buxhetit të vitit të ardhshëm, tashmë janë përcaktuar prioritetet se në cilat fusha do të fokusohen investimet kryesore

se në cilat fusha do të fokusohen investimet kryesore. Sipas draftit fillestar të këtij projektbuxheti, fushat më përparësi, ku do të fokusohen dhe investimet kryesore janë arsimit, shëndetësia, bujqësia dhe infrastruktura. Në vlerësimin e këtyre shpenzimeve janë marrë si bazë

shpenzimet e pashkurtuara nga Akti Normativ 2013, ku është zbritur fondi prej 600 milionë lekësh parashikuar për zgjedhjet dhe shuma është rritur në masën 4 për qind.

Ndarja midis sektoreve është bërë e diferencuar, theksohet në draft, duke

mbajtur rritjen zero për shpenzimet administrative, 2% për sektorët joprioritarë dhe 4-5 % për sektorët prioritarë si arsim, shëndetësi, bujqësi, infrastrukturë. Pak javë më parë, Kuvendi miratoi një Akt Normativ, që ka fuqinë e ligjit, ku u ndryshuan treguesit fiskalë të buxhetit të vitit në vazhdim. Sipas këtij Akti, të ardhurat janë parashikuar në 321.9 miliardë lekë, shpenzimet 405.4 miliardë dhe deficitin buxhetor 83.4 miliardë lekë.


Opozita politike deklaroi se qeveria Rama po e zhyt vendin në borxhe për shpenzime operative, ndërkohë që ul investimin.



Ahmet Prençi
drejtor
i Hetimit
Tatimor

Një ngë drejtuesit më të lartë të Policisë së Shtetit në vite, Ahmet Prençi, mësohet se është caktuar në postin nr.2 për nga rëndësia pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Më parë, këtë pozicion administrativ e ka mbuluar Agim Shehu, ish-drejtor i Policisë deri në vitin 1997, që është shkarkuar nga shefia e re e Tatimeve, Brisida Shehaj. Ndërkohë, është shpallur konkursi për 150 poste të tjera në qendër e në bazë.

KREDI PËR SHTËPI



për kredi në Lekë ose Euro



NBG Bank
Tradicionisht e besueshme



TAP, Haxhinasto: Kompanitë shqiptare gati për punimet

Dje në mesditë Ministri i Transportit dhe Infrastrukturrës, Edmond Haxhinasto takoi Drejtorin Teknik për Zhvillimin e Projektit Trans Adriatic Pipeline AG (TAP), Sigurd Hamre. Ministri Haxhinasto theksoi gadishmërinë për të mbështetur zbatimin konkret për përfundimin me sukses të këtij projekti TAP. Gjithashtu, ministri Haxhinasto

u shpreh se kompanitë shqiptare kanë ekspertizën e nevojshme për t'u angazhuar në punimet e këtij projekti. Ndërsa z. Hamre tha se ka shumë punë publike për të bërë dhe do të vlerësojmë mundësinë e angazhimit të kompanive lokale në punime dhe nëse do të jetë e nevojshme disa prej tyre do të trajnohen me qëllim që të përdoren sa më shumë

burimet lokale. Gazsjellësi TAP do të jetë 870 km i gjatë dhe rreth 209 km kalojnë në territorin shqiptar dhe 110 km në Detin Adriatik (nga të cilat 60 km në pjesën detare shqiptare). Projekti i gazsjellësit TAP është i një rëndësie strategjike që do t'i mundësojë Shqipërisë të bëhet një vend qendror tranziti për sigurinë e energjisë së BE-së.

Bie ndjeshëm çmimi i tokave përreth Porto Romanos

Ç'bëhet me tokat e Fazllicit në Durrës?

TEC-i me qymyr një perspektivë e largët

LAJMI

Mos realizimi i projektit për ndërtimin e TEC-it me qymyr në Porto Romano, i cili u planifikua para 10 vitesh, ka bërë që çmimi i tokës në këtë zonë të bjerë. Ndërkaq pronarët e tokave kanë zgjedhur t'i pronat e konservuara pasi nuk ka të interesuar për t'i blerë ato.

DURRES

ARTUR KORRIKU

Kanë kaluar disa vjet që nga koha kur Damir Fazllic bleu toka në zonën e Porto Romanos që t'ua shiste italianëve të Enel-it për ndërtimin e një TEC-i me qymyr. Ky transakcion do t'i sillte atij fitime që arrinin vlera disa dhjetra herë më të larta se vlera fillestare, me të cilën u blenë këto 8 ha tokë. Por duket se ky projekt i Enel-it ka mbetur nëpër sirtarët e burokratëve të Tiranës të asaj kohe. Në Durrës bëjnë me dije se nuk kanë pasur asnjë kërkesë nga ndonjë grup biznesi i huaj apo vendas për të ndërtuar TEC me qymyr në Porto Romano edhe pse zona me kohë është shpallur park energjitik.



Porto Romano, Durrës

SITUATA

Makthi i banorëve të qytetit të Durrësit i shkakton nga fantazma e një TEC-i gjigand me qymyr që do të furnizonte italianët me energji elektrike duket se është fashitur. Ka disa kohë që realizimi i një projekti të tillë ka dalë nga axhendat e investimeve në zonën e Porto Romanos. As anijet studimore si dhe ato që ngulën pilotat e para në det nuk janë parë më në këto anë. Por ajo që mbetet në këtë histori është toka e Damir Fazllicit, e cila u ble prej tij pikërisht në zonën ku ishte parashikuar që të ndërtohej TEC-i me qymyr.

Ajo është një sipërfaqe toke ligatimore apo moçalore e blerë mjaft lirë nga banorët e zonës, të cilët nuk mund ta përdorin atë si tokë bujqësore. Nëse në Porto Romano do të ndërtohej TEC-i me qymyr, atëherë fitimi nga shitja e kësaj sipërfaqeje do të ishte disa dhjetra herë më i lartë se sa vlera, me të cilën ajo u ble. Në bashkinë e Durrësit por edhe në komunën e Katundit të Ri, të cilat kanë nën juridiksionin e tyre sipërfaqet e parkut energjistik thonë se nuk kanë marrë ndonjë kërkesë për ndërtimin e TEC-it në fjalë

edhe pse fjalën e parë e thotë Ministria e Energjitikës në të tilla projekte.

TOKAT KONSERVOHEN

Banorë të zonës së Porto Romanos sqarojnë se sipërfaqet e tokave në veri të Porto Romanos kanë shumë pronarë, të cilët kanë në zotërim sipërfaqe të ndryshme që nisin nga ngastrat e deri tek ata që zotërojnë sipërfaqe disa hektarëshe. Që të gjithë ata i mbajnë të konservuara këto sipërfaqe pasi kërkuar nuk afrohet të

blejë toka në këtë kohë krize. Edhe Fazllic tashmë e mban të konservuar këtë sipërfaqe toke njëjloji si edhe pronarët e tjerë. Shpresa e tyre e vetme janë biznesmenët e karburanteve, të cilët ndërtojnë herë pas here depozita gjigande për naftë, benzinë, benzol dhe gaz, por edhe ata janë pakësuar gjatë viteve të fundit. Banorët e zonës bëjnë me dije se vlera e tokës ka pësuar ulje të ndjeshme në krahasim me 10 vjet të shkuara kur nisi ndërtimi i parkut energjistik dhe portit të karburanteve.

ERE:

“CEZ të paguajë vetëm KESH dhe OST”

Bordi i Komisionerëve të Enetit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e datës 28.10.2013, shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë së Çmimeve dhe Tarifave, lidhur me skedulimin e pagesave dhe të planshpenzimeve të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. (në administrim të pë-



kohshëm). Në bazë të këtij relacioni është konstatuar se nuk mund të miratohet një planprotokoll që CEZ të mundësojë pagesat që për të, përveçse renditje të zërave prioritare, pa cenuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike. Shkaku për këtë ka qenë gjendja e rëndë, në të cilën ndodhet kompania CEZ. Sipas relacionit, humbjet e CEZ-it arri-

Interkonjeksioni

Itali, linja nënujore, miratohet projekti



Faksimile e faqes web të “Gazzetta del Mezzogiorno”

Projekti italian për ndërtimin e një linje transmetimi energjie nën det, nga brigjet shqiptare, e cila do të mbërrijë në Polignano dhe do vazhdojë në territorin e qyteteve/komunave të Mola-s, Conversano-s, Rutigliano-s, Turi-t dhe Casamassima-s, ka marrë miratime nga institucione të ndryshme, duke përfshirë edhe Departamentin e Energjisë pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (dekreti 239, më 19 shtator). Lajmi e bën të ditur e përditshmjia puljeze “Gazzetta del Mezzogiorno”. Ndër të tjera, thuhet se, sipas pro-

jektit, kjo linjë transmetimi energjie “do të fillojë nga një TEC me qymyr në Porto Romano të Durrësit”. Ndërkaq, shoqëria civile italiane ka kërkuar më shumë trasparencë rreth projektit, duke shprehur shqetësim për pasojat që mund të kenë kantierët e ndërtimit mbi mjedisin dhe zonat e mbrojtura. E përditshmjia bën të ditur se punimet i kryen “Enel Produzione Spa”. Intenjeksioni planifikohet të ketë një shtrirje 31 km në tokë dhe 27 km në det. Parashikohet që kjo linjë të importojë energji nga TEC-i shqiptar me qymyr.

LAJME SHKURT

■ Panariti zhvillon takim me ekspertë të BB-së

Dje, ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Edmond Panariti, priti në takim një grup ekspertësh nga Banka Botërore. Ata diskutuan për mundësinë e sigurimit të fermerëve në bujqësi ndaj kushteve natyrore të pafavorshme. Ekspertëve të Bankës Botërore e cilësuan sigurimin e fermerëve si një hallkë të rëndësishme në zinxhirin e prodhimit të produkteve bujqësore. Bashkëbiseduesit ranë dakord që do të bashkëpunojnë në të ardhmen për kryerjen e disa studimeve, si hap i parë për të rritur kërkesën e fermerëve shqiptarë për sigurim bujqësor.

■ BQE-ja ul normën bazë të interesit, euro bie

Si kundërmasë ndaj inflacionit, Banka Qendrore Europiane (BQE) ka vendosur të ulë normën bazë të interesit në 0.25% nga 0.5% që ishte më parë, duke shënuar kështu një nivel të ri rekord. Për sa i përket interesit të deponizave bankare, BQE-ja vendosi ta mbajë në zero, ndërsa interesin e huamarjes emergjente e uli në 0.75% nga 1% që ishte më parë. Këto vendime të BQE-së kanë ndikuar menjëherë tek monedha euro, duke bërë që të humbë 1.3% të vlerës në raport me dollarin amerikan. Nga ana tjetër yield-i i bonove të një pjese të madhe të vendeve anëtare të Eurozonës shënoi rënie, ndërsa u përforcua tendenca rritëse e bursave.

■ Azia, kontinenti që prodhon më shumë miliardë

Sipas bankave zvicerane UBS dhe Ehealth-X, në vitin 2013 numri i miliardërëve në botë është rritur me ritme rekord. Deri në qershor të këtij viti, numri i miliardërëve u rrit në 2 mijë e 170 persona në nivel global. E thënë ndryshe me një rritje prej 0.5% krahasuar me një vit më parë. Azia është rajoni që ka regjistruar rritjen më të madhe të tyre. Sipas studimit, në këtë kontinent janë afirmuar 18 miliardë të rinj. Ndërkaq, Amerika e Veriut vazhdon të ketë numrin më të madh të miliardërëve. Ndërkohë pas 5 vitesh pritet që Azia të jetë kontinenti me më shumë miliardë. Gjithsesi, Europa mbetet destinacioni, ku të pasurit e botës parapëlqejnë të jetojnë.



Koment

Goja që shqipton fjalët e ligjit



NGA ILIR DHIMA

vijon nga faqja 1

...Nëse ndokujt, si palë e një procesi gjyqësor, nuk i mbushet mendja që një vendim i bazuar plotësisht të legjislacioni në fuqi nuk i jep atij drejtësinë që do të dëshironet, vështrë të të besojtë që e drejta dhe drejtësia (it.: il diritto e la giustizia) janë dy kategori të veçanta, që sidoqoftë e mbështesin njëra tjetrin. Por jo gjithmonë mund të njësohen. Ama, kur gjyqarët - herë me drojtje dhe herë me kapadaillek - mënjanojnë rregullin e përcaktuar, duke e shndërruar atë në një hijë, ata i kundërvihen edhe së drejtës, edhe drejtësisë, të cilat do t'ia detyronin mirënjohjen kujtdo që do t'i jepte goditjen fatale kësaj dukurie.

Tabloja në gjykatat e vendit tënd është e mbushur, në mos plotësisht, së paku pjesërisht me shembujt të

tillë, edhe atëhere kur e drejta dhe zbatimi i saj janë plotësisht të qartë. Dhe, të gjithë ata, madje një popull i tërë, që ballafaqohen drejtpërdrejt apo tërthorazi me shembujt të tillë humbasin besimin te e drejta dhe drejtësia, të cilat nuk janë fajtoare, janë viktime të jo pak gjyqarëve, të anësive, ndikimit politik, interesave të ngushta, paafësisë, pasioneve dhe favoreve personale të tyre. Ndërkohë që, gjyqtari nuk mund dhe nuk duhet ta ndryshojë as forcën dhe as ashpërsinë e ligjit, por ta bëjë udhëtarin, që e di se drita e kuqe ndizet për të ndërprerë kalimin e tij, të jetë i vëmendshëm dhe t'i hapë mirë sytë. Përndryshe, me kaosin e lëvizjeve dhe shtimin e sjelljeve antiligjore në një shoqëri, respekti i saj për gjyqarët bie më shumë se sa për këdo tjetër.

Me sa kuptohet, këto kushte e detyruan t'i hiqte dorashkat e diplomacisë edhe Ambasadorin e SHBA në Tiranë, Aleksandër Arvizu, i cili me pjesëmarrjen e tij në Simpoziumin mbi Etikën Gjyqësore të zhvilluar të martën e kësaj jave nuk mënoi të thoshte, se këtu në Shqipëri disa gjyqarë duhet të ishin në burg. Kjo thënie gjithërokshe vlerësohet në masë të gjërë si një konstatim mjaft realist. Jo, më shumë se sa një konstatim, kjo thënie merr vlerat e një thirrjeje, që plotëson në formatim elementin e ndëshkimit. Të atij ndëshkimi, si

detyrë e kohës, që duhet të veprojë jo vetëm mbi funksionarët dhe nëpunësit e korruptuar apo të kriminalizuar, por edhe mbi ata gjyqarë, të cilët nuk e kanë ndjerë dhe as nuk e ndjejnë veten të barabartë me të tjerët përpara ligjit, duke e shtrembëruar dhe devijuar këtë, për hir të interesave private dhe duke kujtuar se funksioni i tyre ka forcë më të madhe se sa ajo e ligjit.

Në referim të punimeve të atij Simpoziumi, Fjalimi i Presidentit të Republikës, Bujar Nishani, nën drejtimin qoftë edhe administrativ të të cilit është Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk u ndje të ishte në rezonancë me atë të mikut të huaj, që pritet të largohet së shpejti. Megjithëse u kujdes që të mos anashkalonte hap-tazi shqetësimin e përgjithshëm për dobësitë e theksuara në funksionimin e sistemit tonë të drejtësisë, artikulluar fare qartë nga Arvizu, Nishani shprehu vetëm besimin e tij, sipas të cilit, sfida për shtetin ligjor qenka një sfidë që nuk mbaron kurrë. Sigurisht, nuk mbaron kurrë, por duhet të fillojë dikur. Dhe, më e thjeshta, madje më e shpejta është që të nisët nga reforma për pastrimin e gjykatave nga ata që kanë njiollotur fasadat, sallat dhe togat e tyre. Sepse, baticat që përpjijnë funksionarët e tjerë, nuk mund të ndryshojnë rrugën ose drejtimin e tyre

për t'i lënë gjyqarët mënjani.

Vërtet që një nga katër parimet e statusit të gjyqarit është përvokueshmëria nga detyra e tij, megjithatë ky shoqërohet edhe me parime të tjera, prej zbatimit korrektësisht të tyre përvokueshmëria vihet në dyshim, prandaj edhe në shqyrtim. Por, jo siç është vepruar deri tani, kur edhe ndonjë masë administrative e ndërmarrë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, shpesh anulohet nga Gjykata e Lartë. Ose, siç veproi së fundmi KLD, duke futur në veprim Inspektoratin e vet për të zhvilluar një testim për gjyqarët, duke u nisur nga ankesat e qytetarëve të thjeshtë, që më së shumti nuk janë në gjendje t'i formulojnë juridikisht ato. Atëherë, kjo që thamë më lart, mos është një gjë pa krye, apo një sfidë që nuk e lejon shtetin e së drejtës të përballtet me të?

Asgjë nuk është e pazgjidhshme, as në këtë drejtim, kur ekziston vullneti, për t'iu përgjigjur konkretisht

shqetësimin të popullit dhe kërkesave për zhvillime të reja në rrugën drejt Bashkimit Europian. Përvokueshmëria me objektivitet, profesionalizëm dhe pa varritje të dosjeve me vendime gjyqësore të kontestueshme, ka edhe një rrugë tjetër që nuk kërkon ndonjë

stërmundim për të rremuar nëpër analet jurisprudenciale, por në ato të kontrollit të pasurive të deklaruarra dhe të padeklaruarra të çdo gjyqtari. Efektet e përfuturara nuk do të na shkaktonin habinë e një zbulimi, por derisa përfilitjet në këtë drejtim kanë qenë dhe mbeten të shumta. Nuk do të shkaktonin habinë e një zbulimi, por e kombinuar kjo rrugë me të parën do të zgjeronte dhe do të rriste nivelin e transparencës së një prej të vërtetave shkakësore për gjendjen nga duam të dalim. Si në ngrëçet e vdekjes dhe në ato të lindjes, kur bashkë me dhimbjet e ndokujt praktikave që u ka shkuar koha duhet të zhduken dhe

kritere të reja vlerësimi të shfaqen.



KINEMA MILLENNIUM

ADA

Një film nga SPARTAK PECANI

1-10 NENTOR

ADA

1-10 NENTOR

Skeda e filmit

Titulli: Ada

Regjia: Spartak Pecani

Skenari: Mathew Maude

Aktorë: Ndrëçim Xhepa, Iliriana Blakaj, Reshat Arbana, Elvira Diamanti, Astrit Hasanaj, Enver Petrovci, Afrim Muçaj

Gjinia: Aksion, Triller

Sinopsi: Një vajzë e re akuzohet për vrasje të shumëfishtë. Kjo është Ada. Ajo nuk mban mënd asgjë. Familja e saj ndahet midis dy ekstremeve, të punës së ndershme dhe parave të pista. Në qytet shitja e drogës ka marrë përmasa të mëdha dhe vrasje të një pasnjëshme. Është Ada pjesë e kësaj?

Rr: Murat Toptani

Tel: 04 22 53 654 / 22 53 655

www.kinemamillennium.com email: info@kinemamillennium.com

facebook.com/kinema.millennium.tirana



Koleksioni "Nëntori"

Teodor Laço:


Ta bëjmë letërsinë me tendenciozitet klasor revolucionar

"Fjalimi i fundit i shokut Enver për problemet e letërsisë e të artit, ishte si një dritë e madhe për ne..."

Një poezi e Visar Zhitit botuar në numrin 3 të "Nëntorit" 1972 dhe një diskutim i Teodor Laços në Kongresin e Dytë të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë janë përzgjedhja jonë për sot në rubrikën "Koleksioni Nëntori" me krijimtari dhe publicistikë të botuar në revistën "Nëntori" në vitet e diktaturës. Nga poezia e Zhitit mjafton të

shkëpusim vargun "Shiu vazhdon të bjerë, eci me armë në dorë, roje, në gji kam një vëllim të shokut Enver..." për të kuptuar frymën e këtij krijimi, nënshtruar ideologjisë së kohës. Ndërsa diskutimi i shkrimtarit Teodor Laço është i mbytur me perifrastime nga porosita e Partisë e të shokut Enver dhe se si duhet të ishte letërsia dhe artet në atë kohë.

DISKUTIMI i Teodor Laços në Kongresin e Dytë të Lidhjes së Shkrimtarëve me këshilla se si duhet të shkruar letërsia sipas porositve të Partisë dhe një poezi e Visar Zhitit me titullin "Një natë pa gjumë..."



NË FOTO: Kopertina e revistës "Nëntori" botim special kushtuar "Kongresit të dytë të Lidhjes së Shkrimtarëve" ku është botuar shkrimi i Teodor Laços dhe faksimile e faqes së parë të këtij shkrimi

Nga Teodor Laço

Ne ndiejmë ngrohtësinë e madhe që na ka krijuar partia

Kongresi ynë i dytë, që vjen si kurorëzim i një rrugë të gjatë e të vështirë lufte nën udhëheqjen e Partisë, për triumfin e artit vërtetë të realizmit socialist do të mbetet në historinë e artit e të letërsisë sonë si një moment i shquar për nga gjerësia e tij dhe rëndësia e problemeve që po diskuton.

Fjalimi i fundit i shokut Enver për problemet e letërsisë e të artit, që ishte si një dritë e madhe për ne, po na bën sot që t'i përcaktojmë më me pjekuri e guxim, me një qartësi të madhe ideore detyrat tona ndaj popullit e ndaj momentit historik që po hetojmë. Ky moment historik na zbulon çdo çast një heroizëm të madh e masiv, shfaqje të larta të ndërgjegjes revolucionare. Detyra jonë, tani, ndofta i ngjason asaj të shkencëtarit eksperimentues në bujqësi që ndër qindra variante e përsëritje, zgjedh atë varietet që shfaq tiparet më pozitive, tipare të reja e më produktive. Të tjerat i lë pas dore dhe kultivon të renë, të fuqishmen, prodhimtaren, të nesërmen, që jeta materiale të bëhet më e begatë. Edhe shkrimtari, në këtë det ndodhish e fenomenesh të reja duhet të zbulojë atë që është më e re, më e avancuar, tiparet e së ardhmes, dhe t'i kultivojë ato. T'i kultivojë e t'i ngrejë mbi piedestal, sepse po ashtu siç e bën më të begatë jetën materiale çdo varietet i ri, më produktiv, po ashtu e bën jetën shpirtërore të popullit më të begatshme çdo heroi i ri, që mbart tiparet revolucionare, ndërgjegjen e lartë klasore, të nesërmen komuniste.

Që këtu, mendoj se përcaktohet një nga detyrat më kryesore të letërsisë sonë: vënia e heroit pozitiv në qendër të krijimtarisë e të vëmendjes së forcave krijuese. Letërsia jonë po e kërkon dhe po e krijon me këmbëngulje e me sukses këtë hero, po shkruan me dashuri për të; por heroizmi i popullit tonë është i gjerë, i madh dhe i heshtur si deti. Që ta zbulosh atë me gjithë bukuritë e veta, duhet të zhytesh në të "të jetosh gju me gju me të" – siç thotë shoku Enver. Këtë heroizëm masiv, me simbole e përgjithësimet të forta na e ka dhënë disa herë poema t'ë! Megjithatë, ne ijemi ende borxhlinj njeriut tonë të thjeshtë e të madh. Njeriu ynë duhet të jetë shqetësimi

Fjalimi

Pas fjalimit të shokut Enver në Konferencën e 17-të të Partisë në Tiranë, të orientuar nga komiteti i partisë të rrethit, ne bëmë një analizë të gjerë të punës sonë. Krijimtarinë e viteve të shkuara e pamë me një vështrim kritik. Vlerësua sukseset por kritikua fort edhe tendencat e gabuara që mund të ishin dukur ose që mund të duken ende, sepse të zbulosh gabimet e të mësosh prej tyre, do të thotë të krijosh një bazë të fortë për të shkruar më përpara.

ynë i përhershëm. Kur gëzimet e shqetësimit e tij hyjnë edhe në jetën tonë, ahëre ne do të kemi zbuluar shpirtin e tij dhe do të shkruajmë më mirë.

Jam i ngarkuar nga shkrimtarët dhe artistët e rrethit të Korçës t'i them Kongresit se pikërisht këtë mësim dhe detyrë themelore do të mundohemi ta vëmë në jetë më parë se gjithçka tjetër sepse çdo shkrimtar që i shërben revolucionit duhet të revolucionarizojë më parë vetveten, konceptet, mënyrën e jetesës.

Dua të shtroj disa probleme për degët e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve në rrethe, sidomos për rrethin e Korçës, për perspektivat e saj.

Krijimi i degës së Lidhjes në vitin 1962, kishte për qëllim grupimin e shkrimtarëve dhe artistëve, krijimin e një kolektivit krijues ku të vlonte shkëmbimi i sinqertë e mendimeve, kritika në dobi të krijimtarisë së secilit dhe të gjithë letërsisë.

Ky ishte një sukses dhe dega bëri e po bën një punë të dobishme.

Siç duket, kryesia e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve qëllon në shenjë kur i pagëzoi këto organizma të saj me një emër të gjallë, të huajtur nga bota bimore (sepse mund t'i quante edhe seksione ose diçka tjetër), sepse çdo degë e njomë që ushqehet nga një trung i shëndetshëm, rritet e zhvillohet.

Kështu u rritën degët nëpër rrethe, dolën degë të reja, do të dalin edhe të tjera.

Puna është këtu: të mos e lemë degën të rrezikohet nga tharja. Dhe tharja vjen nga mungesa e lëngjeve të reja.

Për fat të mirë, forcat e reja letrare e artistike, erdhën dhe po vijnë me guxim e me ngulim në trungun e Lidhjes dhe në degët e saj.

Lidhja jonë, duhet të kërkojë e të gjejë kurdoherë burimet e t'i thithë si një motopompë këto lëngje të reja, sepse ndryshimet e thella cilësore që kërkojmë në letërsi nuk mund t'i kryejë një grusht shkrimtarësh por një ar-

matë e tërë.

Në rrethin e Korçës, brenda këtyre viteve që nga krijimi i saj, numri i anëtarëve të Lidhjes u trefishua. Sukseset më të mëdha, hë për hë, i kanë prozatorët që në këto dy-tre muajt të këtij viti p.sh. kanë shkruar dhe kanë në shtyp dy romane dhe shtatë përmbledhje tregimesh.

Menjëherë pas fjalimit të shokut Enver në Konferencën e 17-të të Partisë në Tiranë, të orientuar nga komiteti i partisë të rrethit, ne bëmë një analizë të gjerë të punës sonë. Krijimtarinë e viteve të shkuara e pamë me një vështrim kritik. Vlerësua sukseset por kritikua fort edhe tendencat e gabuara që mund të ishin dukur ose që mund të duken ende, sepse të zbulosh gabimet e të mësosh prej tyre, do të thotë të krijosh një bazë të fortë për të shkruar më përpara. Këto tendenca shfaqeshin në disa drejtime dhe janë shfaqur edhe në gjithë letërsinë tonë: si trajtimi i temave anësore, të parëndësishme ose të ashtuquajtura të përjetshme (kujtoni p.sh. se si ca vite të shkuara iu vunë punës me ngulim sikur të ishin në garë dy poetë dhe shkruan e botuan nga një poemë të gjatë me motivet e një poezie të njohur për zemrën e nënës që e ka shkullur biri bukëshkelës për të dashurën e vet). Këto tendenca nuk duken tani më në letërsinë tonë, por, nuk duhen harruar ama.

Nuk janë të pakta veprat ku çdo gjë rreshtet si mbi ujë, kontradiktat zgjidhen me një mbledhje kështu që lufta e vërtetë klasore del e dremitur dhe e zbehtë. Kështu, zbehet edhe heroizmi i vërtetë që triumfon pas një lufte të vështirë me të vjetrën. Shfaqje të kësaj tendence ne patëm në dekadën e parë të rrethit dhe i kritikua me të drejtë.

Por ne u ndalëm gjatë sidomos në çështjen e përtëritjes së Lidhjes me brezin e ri të shkrimtarëve që duhet të mbushë radhët e kësaj armate dhe nxorëm detyra konkrete. Të rinjtë vijnë në letërsi nga rrugë të ndryshme: nga uzinat e shkollat e qyteteve dhe nga shtigjet e maleve, dikush hyn me vrull dhe imponohet dikush hyn më me ndrojtje e me ngadalë, por prapë hyn, dikush mbetet në

Teodor Laço

Ne ndejmë ngrohtësinë e madhe që na ka krijuar partia

Kongresi ynë i dytë, që vjen si kurorëzim i një rrugë të gjatë e të vështirë lufte nën udhëheqjen e Partisë, për triumfin e artit të vërtetë të realizmit socialist do të mbetet në historinë e artit e të letërsisë sonë si një moment i shquar për nga gjerësia e tij dhe rëndësia e problemeve që po diskuton.

Fjalimi i fundit i shokut Enver për problemet e letërsisë e të artit, që ishte si një dritë e madhe për ne, po na bën sot që t'i përcaktojmë më me pjekuri e guxim, me një qartësi të madhe ideore detyrat tona ndaj popullit e ndaj momentit historik që po jetojmë. Ky moment historik na zbulon çdo çast një heroizëm të madh e masiv, çfaqje të larta të ndërgjegjes revolucionare. Detyra jonë, tani, ndofa i ngjason asaj të shkencëtarit eksperimentator në bujqësi që ndër qindra variante e përsëritje, zgjedh atë varietet që çfaq tiparet më pozitive, tipare të reja e më produktive. Të tjerat i lapa pas dore dhe kultivon të rena fuqishmen,

mes të rrugës. Por ne le të mos shqetësohemi se dikush mbeti, le të mos shqetësohemi bile edhe sepse librin e parë të një autori nuk po e pason shpejt edhe i dyti, sepse letërsia ka shumë zhgënjime. Prapë edhe ai libërth i parë, është i dobishëm, sepse shton ato grumbuj sasiorë që kërkojmë dhe që do të sjellin pastaj ndryshime cilësore. Më duket se më kot e kanë kritikuar Ndërmarrjen e Botimeve se qenka nxituar që ka botuar vëllimet me poezi të disa të rinjve sepse poezia e tyre qenka pak më e ulët se niveli i përgjithshëm i poezisë sonë. Çdo letrar i ri sjell me krijimet e veta një botë të re, diçka të tijen, të freskët. Natyrisht ai ka edhe shumë gjëra të huajtura, po këtu duhet ta drejtojmë tani vëmendjen kritikë: në zbulimin e kultivimin e individualeve dhe në shkuljen e të huajturave. Fatkeqësisht kritika jonë letrare rrallëherë merret seriozisht me problemet e të rinjve dhe me veprat e tyre. Edhe ndonjë vështrim recensional që i rrumbullakos problemet me frazën e njohur burokratike: "Sigurisht, vepra ka edhe të meta; por në përgjithësi është mjaft e mirë" nuk ndihmon aspak, ashtu siç nuk ndihmon edhe ajo lloj kritike me syze të zeza që kërkon qimen në vezë dhe që duke u zhytur në terrin e të metave, nuk sheh asnjë filiz që mund të kultivohet. Vitet e fundit ndërmarrja e botimeve, organet tona letrare, vetë Lidhja i kanë zbatuar më mirë mësimet e Partisë për zgjerimin e frontit të letërsisë dhe të artit dhe është rritur dashamirësia për forcat e reja krijuese.

Natyrisht, jemi kundër vulgarizimeve në këtë çështje dhe dihet se jo çdo gjë që fluturon është e ngrënë, fjala është që të bëhet një punë më këmbëngulëse për zbulimin dhe edukimin e talenteve të reja. Veç seminareve të rralla me letrarët e rinj, ç'bëhet për t'i mësuar forcat e reja letrare? Dikush mund të thotë që talenti çan vetë përpara dhe se s'ka asnjë shkollë që të nxjerrë shkrimtarë. Kjo është vërtetë, por mund të ketë shkolla ama, ku të mësojnë letrarët që debutojnë me sukses, të mësojnë estetikën marksiste, gjuhën shqipe, rregullat e drejtshkrimtimit kështu që të mos sfiliten më redaktorët e gjorë duke ndrequr gabimet e prozatorëve të rinj e të mos thonë më: "Gjynah shkretë! Ka talent po i ka keq punët me gjuhën shqipe!". Mund të dalin shumë më tepër talente të reja sidomos nga radhët e nxënësve. Por ata nuk zbulohen dot ose mësojnë të shkruajnë në mënyrë të përgjithshme e bombastike nga disa mësues të letërsisë që janë bërë të tillë nga ndonjë rastësi fatkeqe si ato që ndodhin edhe sot rrallëherë kur letrarët e rinj dërgohen për të mësuar kimi industriale! Kjo mund të duket si shqetësuese por si mund të shpjgohet p.sh. fakti që prej disa vjetësh nga shkolla "Asim Zeneli" e Gjirokastrës po dalin letrarë të mirë që ecin me siguri kurse nga shkollat e tjera të mesme kemi shumë pak? Shpjgohet me faktin se aty punon e drejton talentet një mësues letërsie shkrimtar. Është absurde të mendohet se të gjithë mësuesit të letërsisë të jenë shkrimtarë, por është fare e mundshme të mendohet që kontingjenti i nxënësve që mësojnë për mësues letërsie të zgjidhet me kriterë më të drejta. Për t'i pasur sa më afër

forcat e reja letrare dhe artistike, ne, në rrethin e Korçës, të gjitha aktivitetet e degës së Lidhjes si diskutime krijuese etj., i bëjmë bashkë me anëtarët e rretheve letrare e të arteve figurative që anë pranë pallatit të kulturës dhe ku grupohen talentet më të mira që gjenden në shkolla e qendra pune. Gjithashtu, shkrimtarët kanë nën drejtimin e tyre rrethet letrare në qendrat e mëdha të punës dhe mendojmë që këtë drejtim ta shtrijmë edhe në shkollat e mesme. Një afrim i tillë i përhershëm i anëtarëve të Lidhjes me talentet e reja që janë perspektiva e saj mendojmë se është shumë i dobishëm.

Desha të them edhe disa fjalë për trajtimin e temës së fshatit tonë të ri nga letërsia jonë. Është një fakt i njohur që fshati, më tepër se qyteti, ka tërhequr vëmendjen e shkrimtarëve sidomos të prozatorëve. Kjo ndoshta shpjgohet me origjinën fshatare të shumë shkrimtarëve. Ne kemi tashmë romane të tillë si "Lumi i vdekur" dhe "Ata nuk ishin vetëm" që kanë drama të vërteta të jetës e luftës së fshatarësisë sonë para çlirimit. Edhe proza e shkurtër sukseset e saj më të dukshme i ka pasur kur ka trajtuar temat e fshatit. Ndryshimet e thella revolucionare që kanë ndodhur vitet e fundit në fshatin tonë, në mal ose në fushë, kanë tërhequr shumë vëmendjen e romancierëve. Dolën "Ara në mal", "Brezat", "Kthesa të forta" etj., vepra që duke qenë kundër teorisë së distancës, siç jemi të gjithë, u bëjnë jehonë çështjeve të ditës. Ky është një sukses i gjithë letërsisë sonë, por natyrisht, kjo po nxjerr në pah edhe probleme e vështirësi të reja që duhet t'i kapërcëjmë. Me të drejtë një lexues në "Drita" shkruan se ai vë re në disa romane mbi fshatin, të njëjtat linja si edhe të njëjtën të metë kryesore: zgjidhjen e lehtë e të shpejtuar të konflikteve. Krijohet

përshtypja sikur, me dashje nuk duam të na dalë nga sfera e vëmendjes asgjë dhe bile, duket sikur vepra shihet me syrin "ç'gjë më shpëtoi nga e sotmja pa thënë vallë?". Një trajtimi i tillë që i ngjan një fotografimi masiv të realitetit, është një nga format e skematizmit. Por, këto vështirësi të rritjes janë krejtësisht të kapërcyeshme nga shkrimtarët tanë. Ne shkrimtarët dhe artistët e Shqipërisë, kemi fatin që jetojmë në një epokë të madhe, në një tokë me frymëmarrje të madhe, në atdheun e horizonteve të hapura, duhet ta bëjmë letërsinë të tillë si vetë atdheu ynë, me frymëmarrje të gjerë, me tendenciozitet të theksuar klasor revolucionar. Ne kemi filluar të ngremë godinën e kësaj letërsie: themelet e muret janë të forta, por ndërtesa duhet të ngrihet gjithnjë e më lart, gjithnjë më e fortë. Ne muratorët kësaj ndërtese që ndiejmë rreth vetes ngrohtësinë e madhe që na ka krijuar partia, le të futemi kokë e këmbë në mes të kësaj atmosfere të ngrohtë. Mbi supet tona do të ndiejmë dorën e madhe e dashamirëse të popullit, atë dorë që mban erë vajra makinash dhe erë toke. Dhe ahere do të vëmë në shumë gurë në këtë ngrëhin, të të shkruajmë më mirë, bile edhe vetë do të bëhemi më të mirë, ashtu siç thoshte dikur një poet i madh që kishte dalë nga gjiri i popullit: "Tani e shoh sekretin se si bëhen më të mirë njerëzit, të rritesh n'ajr të lirë, të hash e të flesh me dherin!".

Ne shkrimtarët dhe artistët e Shqipërisë, kemi fatin që jetojmë në një epokë të madhe, në një tokë me frymëmarrje të madhe, në atdheun e horizonteve të hapura

VISAR ZHITI:

"...Në gjë kam një vëllim të shokut Enver"

NË FOTO: Kopertina e revistës "Nëntori 3" mars 1972, ku është botuar poezia e Visar Zhitit "Një natë pa gjumë"



Nga Visar Zhiti

Një natë pa gjumë

Një natë pa gjumë, i lodhur, vetëm, midis natës dhe heshtjes, roje me automatik në dorë. Një natë pa gjumë, eci. Pa cigare, ftohtë, bie shi, këpuçet e mia shtypin gurët e vetmisë, eci. Ytje të lagur. Një natë pa gjumë, mbështjellë me kapotë, jam ushtar, rripi i automatikut mbi supin tim. Duar vajzash më janë varur mbi supe, gishta të gjatë, të bukur, duar që s'i ndërroja me asgjë në botë, tani ky automatik, më i sigurt se çdo dorë, i përjetshëm deri në komunizëm. Një natë pa gjumë, dhe të tjerët nuk flenë, shekulli im nuk fle, horizontet tunden si afishe, të flakura nga era, bie shi me gëzhoja, njomen kapotat e ushtarëve, me kapotë të njomur, eci, me automatik në dorë. Është koha kur armiqtë prodhojnë më tepër tanke se karroca fëmijësh, ajri i botës dridhet nga vibracione vigane, moderne. Vuaj bashkë me ata që vuajnë.

II
Jam me ata që sonte flenë pa bukë, në duar kam prangat e të burgosurit politik, të atij që nuk nënshtrohet, që është KOMUNIST, frëngjia është e vogël, nuk shoh asgjë: pak qiell, pak yje, pak ajër, jam unë ajo koka e prerë vietnameze në duart e shelatit, sytë i kam hapur, sytë e mi vështrojnë të nesërmen, jam unë zezaku, që s'më lënë të shëtit, që s'më lënë të këndoj, që s'më lënë të shkruaj vjersha. Jam unë ai që do të pushkatohet sonte, jam unë ai që do të lindë nesër, që akoma është pa emër, jam unë kudo, kudo, kudo. Shiu vazhdon të bjerë, eci me armë në dorë roje, në gjë kam një vëllim të shokut Enver. Eci, marr frymë, thith ajrin e shqetësuar të botës. Dhe të tjerët nuk flenë, gjersa të agojë, dhe të tjerët nuk flenë, gjersa të dalë dielli që të parakalojë mbi çatitë e lagjes sime, që të parakalojë mbi çatitë e gjithë lagjeve të botës si një avion i kuq që do të shpërndajë në të gjithë rrugët fletët e bardha të fitores dhe të paqes...



Intervista

ÇIPI: Në Teatrin e Komedisë ndjehen të barabartë. Kush punon paguhet, kush nuk punon ikën. Askush nuk mund të qahet se rrogën e atij që punon, e merr ai që nuk punon.”

Diskriminohen aktorët e teatrit me rrogat

Kastriot Çipi: Teatri i Komedisë, ngjiten më shumë premiera, paguhen sa gjysma e homologëve të Teatrit Kombëtar

■ ■ ■ **TIRANE**
DHURATA HAMZAI

Kundër të gjithë kuadrin ligjor dhe parimeve të të drejtave të njeriut, shumica e artistëve të emëruar në Teatrin Kombëtar marrin rroga të konsiderueshme pa bërë asgjë, ndërkojnë që artistët e kontraktuar në Teatrin Kombëtar të Komedisë ose ata që punojmë vetëm me raste premierash si të jashtëm në Teatrin Kombëtar paguhen me rroga ose honorare tejet modeste. Edhe pse praktikisht të kontraktuarit zëvendësojnë me aktivizimin e tyre në TK punën e shumicës së të emëruarve që kanë vite pa u ngjitur në skenë, diskriminimi i tyre nuk mbaron me kaq. Të kontraktuarit që punojnë për Teatrin Kombëtar, pavarësisht se ky është një institucion shtetëror, shprehen se “punojnë në të zezë”, ku nuk u paguhen as sigurancionet, as sigurimet shëndetësore. Artistët shprehen se nuk është “vetëm një diskriminim i hapur”, por edhe një tregues se shteti dhe sistemi ligjor nuk po funksionon siç duhet. Aktorët e Teatrit të Komedisë ndihen të diskriminuar për sa u përket pagave, kur shohim se në Teatrin Kombëtar shumica e kolegëve të tyre marrin paga të rregullta dhe sa dyfishi i tyre edhe në “rastet kur kanë pesë vjet pa u ngjitur në skenë”. Mjafton të paralelizojmë listën e premierave tepër të rralla shfaqur në sytë e publikut me borderonë e rrogave të 65 punonjësve të Teatrit Kombëtar për të parë këtë kontrast të madh që të çon në edhe në shkeljen e kodit ligjor, ku siç argumenton drejtori i Teatrit të Komedisë, Kastriot Çipi, “Në kontratë përcaktohet përshkrimi i punës që do të kryejë punëmarrësi dhe pagesa që do t’i paguajë, për punën e kryer, punëdhënësi”, që në këtë rast është vet shteti.




Kastriot Çipi, drejtor i Teatrit Komedisë

për shembull ato njëvjeçare. Së treti, fondi i projekteve që ka përfutuar Teatri Kombëtar i Komedisë në dy vitet e funksionimit të tij, ka qenë 3-5 herë më i vogël se ai i Teatrit Kombëtar. Prej më shumë se një viti, i kam kërkuar Ministrisë së Kulturës të miratojë një projekt-strukturë të Teatrit Kombëtar të Komedisë, e cila mund të implementohet pa impakt financiar, nëse 7 paga aktorësh të kategorisë së parë, nga të cilat në Teatrin Kombëtar ka 24, t’i kalohen Teatrit Kombëtar të Komedisë. Me dy ministrat e fundit nuk arrita ta miratojë. Shpresoj ta miratojë Ministria aktuale.

Nëse krahasojmë numrin e premierave që ngjiten në Teatrin Kombëtar me atë që ngjiten në Teatrin e Komedisë dhe rezultatin që sjellin ato, çfarë komenti do të bënit për mënyrën si

BORDEROTE

Nëse jeni vërtet e gatshme për ta denoncuar këtë problem, lista e aktorëve të punësuar në Teatrin Kombëtar dhe listat e roleve për çdo premierë janë informacion publik. Mjafton të bëni një listë të thjeshtë të angazhimeve për çdo aktor



Aktorja Marsela Lena në skenë

paguhen?

-Vitin e kaluar Teatri Kombëtar i Komedisë ka realizuar më shumë premiera, ka dhënë më shumë shfaqje dhe ka pasur më shumë shikues se Teatri Kombëtar. Gjasat janë që kjo të ndodhë edhe këtë vit. Nuk duhet të harrojmë gjithashtu se salla e Teatrit Kombëtar të Komedisë

Nëse punëmarrësi nuk kryen asnjë punë, punëdhënësi ka të drejtë të zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme, pas një afati njoftimi prej tre muajsh

ka 200 vende, ndërsa ajo e Teatrit Kombëtar 530. Nëse këto shifra përgasen me ato të financimit, raporti del i përmbytur. Nuk mendoj se ka nevojë për komente të tjera.

Teatri Kombëtar ka një bordero me 65 punonjës ku pagat jepen në mënyrë konstante dhe nuk jam e sigurt nëse janë ngjitur me shumë se gjysma e tyre në skenë gjatë gjithë vitit. Me çfarë justifikohet paga e artisteve të tjerë?

-Për këtë duhet të pyesni në Teatrin Kombëtar dhe në Ministrinë e Kulturës.

A është e ligjshme që punonjësit siç po ndodh me Teatrin Kombëtar marrin një rrogë, pa e justifikuar me një punë konkrete?

-Kodi i Punës thotë se punëdhë-

nësi dhe punëmarrësi duhet të nënshkruajnë një kontratë. Në kontratë përcaktohet përshkrimi i punës që do të kryejë punëmarrësi dhe pagesa që do t’i paguajë, për punën e kryer, punëdhënësi. Nëse punëmarrësi nuk kryen asnjë punë, punëdhënësi ka të drejtë të zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme, pas një afati njoftimi prej tre muajsh.

Ky problem është trajtuar edhe më parë në media, ku ankesat që na kanë ardhur janë se ka artistë që “nuk e shkelin pragun e Teatrit Kombëtar, por shkojnë vetëm tek bankomatit për të tërhequr pagën”. Sa mendon se është numri i tyre nëse kjo është e vërtetë?

-Po më kërkoni të bëj punën tuaj? Nëse jeni vërtet e gatshme për ta denoncuar këtë problem, lista e aktorëve të punësuar në Teatrin Kombëtar dhe listat e roleve për çdo premierë janë informacion publik. Mjafton të bëni një listë të thjeshtë të angazhimeve për çdo aktor.

Teatri i Komedisë, që ju drejtoni, ka ngjitur në skenë disa vepra të suksesshme, ku kam qenë e pranishme kur ka marrë shumë duartrokitje nga publiku. Cili është sekretet i sfidës?

-Nuk ka asnjë sekret. Këtu të gjithë ndjehen të barabartë. Kush punon paguhet, kush nuk punon ikën. Askush nuk mund të qahet se rrogën e atij që punon, e merr ai që nuk punon.

Çfarë mund të na thoni për premierën më të fundit që pritet të ngjiten në skenë?

-Nuk e dimë ende kur do të jetë premiera e ardhshme. Do të presim të mësojmë buxhetin para se të bëjmë kalendarin e vitit 2014.

Marsela Lena

Aktorët me kontrata në Teatrin Kombëtar punojnë në të zezë

Një nga aktoret e reja, Marsela Lena, e cila angazhohet me kontrata në pjesën më të madhe të premierave që ngjiten në skenën e Tiranës zbulon sesi aktorët punojnë në të zezë, pikërisht në një institucion shtetëror, siç është Teatri Kombëtar: “Unë edhe pse tregu i punës është i vështirë dhe jam artiste e re, jam me atë që artistët të kontaktohen për punën konkrete që



Marsela Lena

do të bëhet dhe në bazë të punës konkrete që bën një artist. Thelbi i problemit qëndron se artistët e rinj, në momentin që lidhin një kontratë me Teatrin Kombëtar nuk u paguhen sigurimet dhe as sigurimet shëndetësore. Kjo ndodh edhe me Teatrin e Metropolit. Pra ne punojmë në të zezë, edhe pse puna jonë faktohet dhe janë muaj ose vite pune sipas kontratës. Ndryshe ndodh

me aktorët me pagë fikse të TK-së, të cilët vazhdojnë të kenë sigurimet edhe kur nuk kanë konkretisht ndonjë rol për një periudhë të caktuar kohe. Do të ishte e ndershme që pavarësisht se na jepen kontrata me ndërprerjet në kohën që punojnë të ishim të siguruar. Ndryshe vepron Teatri Kombëtar i Komedisë, aty na paguhen sigurimet për kohën që ne punojmë me një projekt”



Edicioni 52

RIKTHIMI do të jetë një moment i veçantë për organizatorët e festivalit, ku surprizat gjatë komunikimit të kompozitorit me publikun janë lënë në dorë të Petri Bozdos

Rikthehet Shpëtim Saraçi për Festivalin e Këngës

Të shtunën kthehet në Shqipëri, i gatshëm të fillojë punën

TIRANE

DHURATA HAMZAI

Kompozitori i njohur Shpëtim Saraçi, të shtunën kthehet në Shqipëri i gatshëm të fillojë punën. Kështu ka konfirmuar drejtori artistik i festivalit të këngës në RTSH, Edmond Zhulali, dje në një konferencë që u dha për mediat për platformën e këtij festivali. Ndërkohë që qarkullon ende një skepticizëm i madh për cilësinë e festivalit të këngës në RTSH, dje në konferencën për shtyp që dhanë organizatorët e këtij festivali kishte një lajm shumë të mirë. Shëndeti i kompozitorit Shpëtim Saraçi është përmirësuar. Tashmë ai do të rikthehet të bashkëpunojë me organizatorët e festivalit të 52-të të këngës në RTSH si drejtor artistik. Shpëtim Saraçi për më shumë se dy muaj ka qenë për kurim në Gjermani, në një gjendje të rëndë shëndetësore, pasi mori disa goditje ishemike në trurin e vogël. Pas përpjekjeve të jashtëzakonshme të familjes së tij në bashkëpunim me mjekët gjermanë, kompozitori e ka marrë gradualisht veten dhe tashmë rezulton në një gjendje të përmirësuar shëndetësore. Saraçi ka qenë një nga njerëzit më të përkushtuar të skenës së këtij festivali dhe një nga më profesionistët e rrallë në vlerësimin e elementeve artistike. Rikthimi i Shpëtim Saraçit do të jetë një moment i veçantë për organizatorët e festivalit, ku surprizat gjatë komunikimit të kompozitorit me publikun i janë lënë në dorë regjisorit të këtij festivali Petri Bozdos. Dje organizatorët konfirmuan edhe njëherë se edicioni i 52-të i këngës në RTSH do të zhvillohet në datat 26, 27 dhe 28 dhjetor. Përfundimisht vetëm 16 këngë do të konkurrojnë për çmimin e parë të edicionit të 52-të të Festivalit të Këngës në Radio-Televizionin Shqiptar, nga 28 që ka qenë tradita e viteve të kaluara. Kështu kanë pohuar dje konferencë për shtyp organizatorët e festivalit. Sipas tyre janë paraqitur 40 këngë. Shkurtimin e numrit të këngëve organizatorët e kanë argumentuar jo si rënie të nivelit të festivalit, por si një platformë që sjell risi. Edhe pse nuk është shumë bindës ky argument, drejtori artistik i festivalit është shprehur përkundër faktit të rënies së nivelit të festivalit që është bërë shumë i kritikueshëm vitet e fundit se ka "një rritje cilësore". Ndërkohë mësojmë se për këtë vit drejtori i Festivalit do të jetë Alfons Zeneli, njëherësh edhe drejtor i Radio Tiranës. Ndërsa producent muzikor do të jetë kompozitori Alfred Kaçinari. Regjia e festivalit të këtij viti i është besuar Petri Bozdos, skenari Alda Bidës, ndërsa skeno-



Shpëtim Saraçi

grafia mjeshtrit Adnan Kastrati dhe drejtor artistik Shpëtim Saraçi dhe Edmond Xhulali. Formula e këtij viti parashikon që natën e parë të festivalit të prezantohen tetë këngë konkurrenca dhe tetë të tjerat natën e dytë. Përgjatë dy netëve të para në skenën e Festivalit të Këngës do të jenë të pranishëm edhe artistët e njohur, Big, të cilët do të këndojnë duete

me konkurrentët e këtij viti, këngë të njohura të kënduara përgjatë viteve në skenën e festivalit të RTSH-së, ku regjisor Bozdo shprehet se "do të shtojë edhe më shumë nivelin e performancës së këtij eventi". Gjatë dy netëve të para nuk do të ketë seleksionim dhe në natën e tretë të 16 këngët konkurruese do të ngjiten në skenë duke i dhënë kështu mundësi

FESTIVALI

Përgjatë dy netëve të para në skenën e Festivalit të Këngës do të jenë të pranishëm edhe artistët e njohur, Big, të cilët do të këndojnë duete me konkurrentët e këtij viti, këngë të njohura të kënduara përgjatë viteve në skenën e festivalit të RTSH-së



Organizatorët e festivalit të RTSH

publikut të njohë më mirë këngët dhe konkurrentët e këtij viti. Festivalit nuk do t'i mungojnë elementët e spektaklit, por edhe diskutimi apo hapësira të përcaktuara të kritikës. Siç është bërë traditë e këtyre tre viteve të fundit, secila prej këngëve konkurruese është e zbërthyer në partitura dhe interpretimi do të realizohet live në shoqërinë e Orkestrës së RTSH-së.

Sot me Budinën çelet jave e Filmit Shqiptar në Nju Jork



Ceremonia e hapjes së Javës së Filmit Shqiptar do të zhvillohet sot në teatrin prestigjioz të Neë Yorkut "SVA Theatres" në orën 7:00. Në Red Carpet Gala do të jenë pranishëm një të kulturës kinematografike shqiptare nga e gjithë bota. Nata e parë e festivalit do hapet me filmin e suksesshëm "Agon" me regji të Robert Budinës, përzgjedhje zyrtare e Oscarit 2013. Regjisor i mirënjohur Budina do të marrë pjesë edhe në forumin kulturor rreth artit shqiptar dhe kinematografisë që do zhvillohet pas shfaqjes së filmit "Agon". Në këtë edicion do të shfaqen 30 filma të kinematografisë shqiptare. Fituesit do të shpallet natën e fundit të festivalit me datë 14 nëntor 2013.

Festohet 50-vjetori i videoartit në galerinë Zeta

100 x 100 = 900" titullohet projekti për të festuar 50-vjetorin e videoartit, që u prezantua në galerinë e artit "Zeta". Projekti përmban 100 video artistike, 2-3 minuta secila, ku përfshihen ngjarjet më të rëndësishme të shekullit XX. Ky projekt i veçantë këtë herë ka marrë jo pak interesin e publikut, pedagogëve të artit, etj, të cilët në këtë 50-vjetor të video artit bëhen pjesë të këtij aktiviteti, që do të vijojë edhe sot në mjediset e galerisë "Zeta" në Tiranë. Projekti është ndërtuar nën kujdesin e "Magmart/video under volcano", Festivali Ndërkombëtar i Videoartit, i cili ka përzgjedhur artistët kryesisht nga fituesit e edicioneve të fundit të festivalit.

Promovohet Enciklopedia e Krimin Komunist

Ministrja Kumbaro: Jam nga një familje që ka vuajtur nën prangat e sistemit komunist

Promovimi i vëllimit të dytë të fjalorit Enciklopedik të Viktimave të Sistemit Komunist është bërë dje në Muzeun Kombëtar Historik, ku morën pjesë Ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro, Thomas Schrapel, Kreu i Fondacionit Konrad Adenauer, Kreu i Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pashajev të Komunizmit, Agron Tufa, si dhe intelektualë, ish-të përndjekur, diplomatë, etj. Ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro, tha se: "Unë jam e emocionuar që e mbaj në dorë këtë libër, jo vetëm për vlerat e tij historike, por edhe për vlerën e tij shkencore. Ky libër i ndërtuar me parametra shkencore dhe sipas të gjitha kërkesave që kanë të bëjnë me një kërkim shkencor, përmban një informacion mjaft të vlefshëm që i thotë jo harresës". E emocionuar me libër në dorë, ministrja e Kulturës Kumbaro



kujtoi se i përkiste një familje ku prangat e terrorit komunist i ka ndjerë në duart e gjyshtit të saj. "Unë jam pjesë e një familje që ka vuajtur nën terrorin e prangave të sistemit komunist. Gjyshi im u dënua si tradhtar dhe familja ime vuajti pasojat, prandaj emocionohem kur kam një vepër të tillë në dorë", tha ministrja e Kulturës. Agron Tufa, Kreu i Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pashajev të Komunizmit, tha se ky vëllim vjen 6-muaj pas publikimit të vëllimit të parë. "Në faqet e këtij fjalorit, të nisur 6-të muaj më parë, i bëhet me dije gjithkujt që interesohet për përmasat e krimin, dhunës, terrorit, shtypjes, sikundër dhe formave të përndjekjes që shteti komunist njëpartiak ka ushtruar mbi qytetarët shqiptarë gjatë gjithë ekzistencës së tij, para dhe

gjatë ushtrimit të pushtetit", tha Tufa. Sipas tij, përveç përmbushjes së kësaj detyre të dëshmisë dhe kujtesës, si detyrim moral ndaj të vdekurve, sidomos kur ata janë viktimë të pafajshme e të pambrojtura, ISKK synon, njëkohësisht, krijimin e një baze të dhënash kombëtare me të dhënat më të plota për numrin e përgjithshëm të qytetarëve shqiptarë të persekutuar politikisht nga regjimi komunist i Enver Hoxhës dhe Ramiz Alisë. Hartimi i këtij fjalorit Enciklopedik nisët nga një ide e thjeshtë, në mbarim të çdo lufte, veprimi i parë që kryhet, është numërimi i viktimave, hartimi i një liste zyrtare të viktimave. Nën një regjim terrori, i cili zgjati për afër 50 vjet, përmasat e plojës tejkalojnë çdo betejë të thjeshtë. Prandaj, duke patur parasysh se nuk ekziston një bazë të dhënash të plotë të viktimave që shkaktoi persekutimi komunist ISKK vendosi të fillojë projektin e këtij fjalorit në shtatë vëllime pas një vëllim me shtojca e plotësime.


D.H.U.



Intervista


UNE NUK JAM i bukur. Dhe as nuk e kam lidhur ndonjëherë veten me ndonjë ikonë bukurie të them të drejtën

Linda Halimi
Bashkëpunon me Snup Dog në studion e Puff Daddy



Linda Halimi po bën të gjitha përpjekjet për t'ia dalë në shou-bizin amerikan. Ajo është duke kërkuar dhe duke punuar me njerëzit më të fuqishëm në industrinë muzikore amerikane, për tu bërë një nga këngëtarët e ardhshme me influencë në këtë treg. Së fundmi ajo ka incizuar këngën e re në studion e këngëtarit Puff Daddy, ku ka treguar këtë fakt edhe përmes rrjeteve sociale ku ka shkruar. "Duke krijuar (incizuar) hitet në studion e Puff Daddy-t me tekstshkruesin Jack Knight. Gjithashtu gjithçka është regjistruar nga kjo zonjë profesioniste e cila ka bërë një punë të mirë dhe e bëri sikur një dokumentar për 2 orë", ka shkruar Linda, duke mos dhënë më shumë detaje. Ndërkohë veç këngëve ajo ka realizuar edhe një set fotografish me Fadil Berishën, ku vjen tërësisht e transformuar.

Këngëtarja
Tuna Sejdiu:
"Vdes për të rilindur"




Në vdes, është vetën për të rilindur", ka shkruar Tuna në mbishkrimin e fotos që shihni. E bukur, seksi, dhe tejet tërheqëse, këngëtarja ka bërë një set fotografish, në të cilat ka vënë në pah linjat e saja trupore. Ajo çka vërehet më shumë në këtë foto është fustani i saj i veçantë, i cili përmban imazhin e një Shqiponjës. Nuk e dimë nëse këngëtarja, me anë të kësaj pamje është munduar të lërë ndonjë mesazh për dikë të caktuar, apo thjesht ka shfaqur simpatinë ndaj Shqiponjës.

REDI JUPI:

Ikona e bukurisë për mua, Uma Thurman

Futbollisti i njohur flet në "Nitro Time" për sportin dhe veten



NË FOTO: Ish-futbollisti Redi Jupi dhe aktoria Uma Thurman

me të jatën e atij. Tani prit të biem në fund të greminës.

Ç'mendon për bukurinë, kush është femra e bukur që ke qejf?

Unë nuk jam i bukur. Dhe as nuk e kam lidhur ndonjëherë veten me ndonjë ikonë bukurie të them të drejtën. Unë e falenderoj për komplimentin. Por në përgjithësi

nuk është se kam pasur ikona, kam pasur shembuj për t'u ndjekur në karrierën profesionale. Unë ndonjë femër kë kam qejf?? Aaaaa, këtu më rriUma Thurman

TIRANE
DASARA KARAIKAJ

Si ndihesh kur bën komente për sportin?
Është një çikë e vështirë për të thënë, përse më pëlqen dhe a më pëlqen të bëj opinione sportive në televizione. Jam futur pak rastësisht në pjesën e opinion-bërjes në sport. Ishte një ofertë që m'u bë nga Top Channel në atë kohë.

Nuk është se e kisha menduar, por ditë pas dite duke kaluar kohë e pashë që ishte një drejtim, i cili edhe mund të më pëlqente pra...edhe mund të më pëlqente.

Pastaj problem është që kjo gjë m'u kthye në profesion në kupimin që, unë kam 5 vjet tashmë që merrem me bërjen e opinionit nëqoftëse mund ta pretendoj këtë fjalë në televizione. Patjetër që duke kaluar koha më pëlqen, sepse kam investuar shumë kohë, nuk është se unë kur dal atje dhe bëj opinion për diçka rreth fushës sportive, atë e mbuloj me shumë përgatitje dhe lexime që lidhen me po të njëjtën temë. Domethënë ka një përgatitje paraprake shumë të gjatë për të secilën nga ato tema që neve trajtojmë.

Në fakt kjo është një çështje për të cilën nuk mund të jap një përgjigje, sepse është një process. Kjo ka lidhje me atë nuk e di a e di atë barcaletën. Me dy njerëz që ishin duke u ngjitur dhe tjetri duke rënë poshtë. Dhe ai i tha...po prit të bie poshtë pastaj më pyet...prit një herë të bie në fund fare. Unë jam në proces me Jonuzajn, jam në bisedime

Spektakli

Besa, e preferuara e Këngës Magjike



Në mesin e shumë emrave të njohur të skenës sonë që janë pjesë e festivalit "Kënga Magjike", këngëtarja Besa Kokëdhima duket të jetë më e favorizuar prej kolegëve të saj Kënga e saj "Tatuazh në zemër" është pëlqyer dhe ndarë nëpër rrjete sociale nga këngëtarët si Alban Mehmeti, Beatrix Ramosaj, Miriam Cani e shumë të tjerë. Ndërkaq Cani ditën e djeshme (e mërkurë), ka lënë edhe një mbishkrim, ku këngën e Besës e quan 'këngë magjike'. "Beautiful Song...I uroj Besës nga zemra shumë suksese me Këngën e saj vërtet magjike", ka shkruar Miriam në faqen e saj zyrtare në "Twitter"

Thirrja

Fansat, kërkojnë grupin Elita 5 në Eurovizion 2014



Fansat e grupit të njohur shqiptar nga Maqedonia, Elita 5, ka disa ditë që po bëjnë thirrje në rrjetin social Facebook për të mbledhur sa më shumë adhurues në mënyrë që ky grup të shkojë në Eurovizion 2014. Sipas menaxhmentit të faqes së fansave, kjo ka

qenë ide e vetë fansave të cilët me anë të rrjetit social Facebook, propozojnë që këtë bend ta çojnë në Eurovizion 2014. "Elita 5 nuk ka thënë ndonjëherë që do marrin pjesë në Eurovision, por kjo faqe në rrjetin social Facebook është hapur nga fansat e

"Elita 5" të cilët po mendojnë që të flitet sa më shumë për këtë gjë në mënyrë që të bëhet e mundur. Prandaj të gjithë ata që dëshirojnë të njëjtën gjë si ne ju ftojme të na ndihmoni duket tuar shokët tuaj të bashkohen në këtë faqe", thuhet në faqen e "Elita 5"

Satirë politike

Këshilla falas për Lulëzim Bashën dhe opozitën



NGA ARBEN DUKA

Pjesa e parë

vijon nga faqja 1

Mbase opozitën,
nuk e kishin pritur,
dhe për sakrificë,
s'janë të përgatitur!

Po shoh i çuditur,
se si këtë vjeshtë,
PD-së po i ikin,
antarët e thjeshtë.

Për këtë braktisje,
duhet shpallur zia,
se të thjeshtët janë,
zjarri dhe fuqia!

Unë të thashë o Luli,
po ti s'më kuptove,
të thashë-nuk u zgjodhe,
por u bojkotove.

Ishin regjistruar,
njëqindmijë antarë,
kur ti me Oldashin,
po bënit një garë.

PD-ja qe shkrehur,
kot bëje si xhind,
s'erdhën të votonin,
as tridhjetë përqind.

Duhet ta kuptoje,
rrugën pa e nisur,
kupolë e PD-së,
ishite e braktisur!

Kur s'vjen të hedhë votën,
antari i partisë,
që në fillim shkruhet,
fundi i historisë!

Nuk qe një çudi,
që u batërdisë,
se juve- të thjeshtët,
më parë i braktisë.

Juve i braktisë,
me kohë njerzit tuaj,
gjithë ç'ishin jashtë klanit,
ishin krejt të huaj.

Tani që të shkruaj,
po ta them or mik,
se sot për pushtetin,
s'përbën një rrezik.

Je në situatë,
krejt të sëkëlldishme,
se sot opozita,
është e papërfillshme.

Katastrofa s'është,
vetëm në Kuvënd,
ajo po firon,
anë e mbanë në vënd.

Keq po i humbet,
që të gjitha zgjedhjet,
se nuk ke fuqi,
që të ndalosh rjedhjet.

Për humbjet askujt,
s'i kërkuat ndjesë,
ndaj askush këtu,
s'ju shikon si shpresë.

Ju njerzit rreth vetes,
i mendoni miza,
për humbjet e thella,
s'bëni analiza.

Kush postin ta dha,
ta futi vërtet',
për të fshehur fajet,
si i marrë bërtet.

Po ai PD-në,
krejt e shkatërroi,
dhe me pak përlojtje,
çdo gjë e kaloi!

Nuk mund që të zgjidhej,
kryetar i ri,
për sa kohë i vjetri,
s'kish dhënë llogari!

Lirikë dashurie

Lamtumirë..

S'kam dashur kurrë të të lëndoj,
se të kam dashur sa s'ka më,
po ti më ikën-më largohesh,
ndaj dhe unë ika-po të lë.

S'besoj se do lëndohesh shumë,
ti ende s'di ç'është dashuria,
ndaj s'munde ta kuptoje dot,
prushin e ndjenjave të mia.

Veç bukurisë së pakursyer,
natyra gjë s'të ka dhuruar,
ishite një gonxhe që nuk çele,
u vshkë që pa lulëzuar.

Dhe pse e kam kaq të vështirë,
po të përzë nga zemra ime,
më mirë ndriço si yll i largët,
dhe më dil veç në ëndërrime.

Pas meje do të vijnë të tjerë,
dhe do të puthin puthjen time,
e ti ashtu si dhe me mua,
do shkrihesh nëpër përqafime.

E do t'u thuash-hipokrite:
"O sa të dua-s'e them dot!",
edhe njëlloj si dhe me mua,
fare më kot do derdhësh lot.

Në sa krevate do të shtrihesh,
dhe do të hiqesh virgjëreshë,
kur i mendoj këto të gjitha,
më vjen të qaj edhe të qesh.

Unë gjer tani isha i nxehur,
nuk e mohoj që prapë të dua,
sikur të puthesh me gjithë botën,
askush s'i ndez buzët e tua.

Unë vetë isha i lënduar,
e ndofta të lëndova shumë,
kush vallë di të përkëdhelë,
ashtu siç përkëdhelja unë?!

Megjithatë po të uroj,
u bëfsh prapë yll e lëshofsh nure,
më pas besoj se dhe për mua,
do çelë me gaz një tjetër lule.

Mbi ndjenjën tonë ra dëborë,
gjithçka më tutje është e kotë,
pra lamtumirë-veç lamtumirë,
se mirupafshim s'të them dot!..

NGA ARBEN DUKA

VIP dhe RrPa

NGA ARBEN DUKA

Petro **Markos**

Je veç Një në këto vënde,
një të dytë si ty nuk gjej,
me "Hasta la Vistën" tënde,
do të mburrej Heminguej!

Ernest **Heminguej**

Janë të rrallë ata që vihen,
me ty mik në një ballancë,
se luftën më të përgjakur,
e ktheve në një romancë!

Janis **Ricosit**

Herët në rininë e herët,
si një "Bibël" poshtë kokës,
të veçuar nga të tjerët,
mbaja "Mëhallat e Botës"

Sergej **Esenin**


Ty të desha menjëherë,
para moshës së rinisë,
dhe vuaj që atëherë,
nga Sindromi i Poezisë!



Lermontov

Ti për Pushkinin e lavdishëm,
mbi ligësinë hodhe tërmete,
po atë hymn aq të fuqishëm,
sikur e shkrove dhe për vete!

7 nëntor 2013



Kombëtarja

Sampdoria kërkon De Biasin, Sadiku rikthehet kuqezi

■ ■ ■ **TIRANE**

Trajneri i ekipit përfaqësues të Shqipërisë De Biasi sipas medieve italiane është në planet e presidentit të Sampdorias për firmosur nëse do të shkarkohet Delio Kosi. Rezultatet e dobëta të trajnerit aktual kanë shtyrë presidentin që të mendojë për zëvendësuesin e trajnerit aktual. Në

listën që mediat italiane japin është edhe De Biasi, i cili sapo ka firmosur një kontratë me kombëtaren e Shqipërisë edhe për dy edicione të tjera me të drejtë rinovimi nëse Shqipëria do të kualifikohet në kampionatin Evropian të Francës në 2016. Shanset janë shumë ta vogla që De Biasi të pranohet ofertën e Sampdorias, që do të thoshte prishje e kontratës me

Shqipërinë, që sapo e firmosi, pasi ashtu sikur edhe ai ka deklaruar ka një projekt afatgjatë me Shqipërinë duke premtuar se do ta çojë larg. Ndeshja e radhës e De Biasit me Shqipërinë është përballë Bjellorusisë në një miqësore që do të zhvillohet në Turqi. Për këtë ndeshje, De Biasi është duke bërë gati edhe listën me futbollistët që do të thërrasë. Por

sipas burimeve nga FSHF i pari që do të rikthehet në listën e italianit është sulmuesi Sadiku, i cili luan në Zvicër. Sadiku ka pranuar ftesën e kombëtares për ndeshjen me Bjellorusinë dhe shumë shpejt pritet që t'i bashkohet në Turqi italianit për ndeshjen miqësore me Bjellorusinë. Lista me emrat e plotë pritet të zbardhet në ditët në vijim.

Trajneri i Vllaznisë dhe Grima dy ndeshje jashtë

Disiplina dënon Laçin Skënderbeun e Canajn

FSHF s'merr masa parandaluese, vetëm dënon

LAJMI

Të dënuarit e radhës nga Disiplina janë Skënderbeu, Vllaznia, Laci dhe shumë ekepe të tjera në futbollin shqiptar, por edhe shumë futbollistë për ofendime ndaj zyrtarëve dhe arbitrave. Fenomeni është alarmant nga java në javë, teksa FSHF pret vetëm të dënojë, s'ka masa parandaluese.

■ ■ ■ **TIRANE**

DYLBER BALLA

Komisioni i Disiplinës pranë Federatës Shqiptare të futbollit vazhdon që të veprjë me dorë të hekurt ndaj fenomenit të dhunës që ushtrohet në fushat e futbollit shqiptar nga java në javë, por deri tani nuk ka marrë ndonjë nismë për parandalimin e saj. Ajo që bie në sy nga njëri vendim në tjetrin është numri i lartë i personave të dënuar. Dënimet janë alarmante, madje edhe tek të rinjtë duke premtuar një të ardhme të rrezikshme. Në vendimet e radhës janë dënuar Skënderbeu, Vllaznia, Laçi nga ekipet e Superligës, por edhe Grima me Canajn duke e kthyer Vllazninë në 'kokë turku'. Skënderbeu dhe Laci për sjellje të gabuar të spektatorëve dënohen me zhvillimin e 1 ndeshje pa spektatorë. Zyrtarët e Vllaznisë Armir Grima dhe Agim Canaj për ofendim të zyrtarëve të ndeshjes dënohen me 2 ndeshje pezullim. Lojtari i Luftëtarit Artjon Këndella për sjellje jo sportive ndaj kundërshtarit dënohet me 2 ndeshje pezullim. Masazhatori i Tomorit Jorgaq Morava për ofendim të zyrtarëve të ndeshjes dënohet me 2 ndeshje pezullim. Lojtari i Këlcyrës Entilion Kamberaj dhe lojtari i Memaliajt Adelaid Caushi për sjellje jospportive ndaj kundërshtarit dënohen secili me nga 1 ndeshje pezullim. Lojtari Erzenit Laert Bejko dhe lojtari i Shenkollit Armando Ceka për dhunë ndaj



lojtarit kundërshtar dënohen secili me nga 5 ndeshje pezullim. Zyrtari i Erzenit Altin Kec për sulm dhe dhunë ndaj lojtarit kundërshtar dhe nxitje të akteve të dhunës dënohet me 48 muaj pezullim nga aktiviteti

bazuar në nenet. Erzeni për sjellje të gabuar të spektatorëve dënohet me zhvillimin e 4 ndeshjeve pa spektatorë. Pas vendimit të Disiplinës kanë reaguar edhe drejtësit e Vllaznisë duke e cilësuar si

të papranueshëm vendimin. Dënimet për shkak të trazirave që u krijuan në ndeshjen me Bylisin, ku Vllaznia pretendonte më shumë se një barazim, por fitorja u mohua nga gjyqtari sipas shkodranëve.

Alegri:

“Barça e fortë, Baloteli ka qenë rezervë te Interi dhe te City”




Murinjo u shpreh i kënaqur pas Shalkes duke vlerësuar lojën e ekipit. “Është një rezultat i mirë për ne, diçka fantastike sepse pas humbjes me Baselin gjërat u bënë më të vështira. Akoma nuk jemi kualifikuar, por jemi shumë pranë. Nga Eto'o nuk jam i surprizuar. Nuk ishte në formën më të mirë kur erdhi pas 2 vjetësh qëndrim te Anzhi. Tani hap pas hapi po ecëm mirë” tha ai. Ndërsa trajneri i Milanit, Alegri ka falenderuar djemtë e tij për karakterin dhe lojën në Barcelonë pavarësisht

rezultatit negativ që pritej. “Më vjen keq pasi pësuum dy gola në rrethana të paqarta. Për ne ishte e vështirë, por unë ju bëj komplimente djemëve. Preferova të luaj me Robinjo-Kaka, pasi Baloteli nuk ishte në formën më të mirë, plus që edhe te Interi dhe te City ka qenë rezervë. Por jam i kënaqur me paraqitjen e skuadrës. Trajneri varet gjithmonë nga rezultatet, por vendimet për të i verëson klubi. U përballëm me Barcelonën dhe ndeshja ishte e hapur deri pak minuta para fundit” deklaroi ai.

Legjionarët

Berisha debuton në EL, Cana në formacion



Pas Champion League radhën për të zbritur në fushë e ka pasur Evropa League, kompeticioni i dytë nga rëndësia në Evropë për klube. Në fushë kanë zbritur shumë ekepe, të cilat janë në garë për të kaluar në turin tjetër eliminator. Për shqiptarët me rëndësi ka qenë debutimi i Berishës me Lacion në Evropa League duke e nisur ndeshjen titullar bashkë me Canën. Ndërsa në ndeshjet e tjera, Fiorentina ka arritur që të fitojë përballë Pandurit me rezultatit 1-2, Rubin Kazani ka fituar me Uiganin. Bordo ka humbur në Nikosia me Apoelin. Valencia ka fituar me vështirësi me St. Gallen në Zvicër.

LAJME SHKURT

■ **Leo Messi: Po rikthehem akoma më i fortë**
Messi pas golit dhe fitores me Milanin shprehet se problemet e fundit me lëndimet kishin ndikim negativ në formën e tij. “Kalova dy lëndime vërtet afër njëri-tjetrit dhe kjo është një gjë që ka ndikim. Por përfundimisht i kam kaluar dhe jam i kënaqur me formën time. Jam i qetë për rikuperimin. Po e fitoj ritmin dalë ngadalë. Messi pësoi lëndim në ndeshjen ndaj Almerias në shtator dhe qëndroi jashtë fushë për tre javë, dhe që atëherë ka dështuar të tregojë formë të mirë.

■ **Klop: Vetëm Bayerni mund të ndalojë Arsenalin**
“Arsenali mund të fitojë Champions League vetëm nëse nuk luan ndaj Bayern Munich. Ata janë të rinj, të shëndetshëm dhe të mirë, fituan një ndeshje të zgjuar me ne. Ne krijuam shumë më shumë shanse në sulm por ata shënuan me shansin e parë të ndeshjes dhe ne nuk arritëm të rikthehemi. Kjo disfatë mund të ishte shmangur. Është një grup shumë i fuqishëm dhe lajmi pozitiv sonte është se dy fitore dhe ne kualifikohemi” kjo është deklarata e trajnerit të Dortmundit, Klop.


■ **Higuain: Fitorja ishte vendimtarë për Napolin**
Sulmuesi i Napolit, Gonzalo Higuain është i emocionuar pas dy golave të shënuar në fitoren 3-2 ndaj Marseille duke e afruar Napolin akoma më shumë me kualifikimin në turin tjetër. “Jam në formë të mirë, ndjehem më mirë gjithë kohën dhe shpresoj ta ndihmon skuadrën të arrijë rezultate të rëndësishme. Me Marseille ishte ndeshje shumë e vështirë dhe ishim të vetëdijshëm se do të jetë e tillë. Fitorja ishte vendimtarë për Napolin për të qëndruar në krye të grupit. Jemi të kënaqur dhe e dinim se ky do të jetë një grup shumë kompleks, por ne duhet të japim gjithçka” përfundoi ai.

PARADE FJALEKRYQESH NGA

Kadri Vokopola



FJALEKRYQI SPORTIV



HORIZONTAL

- 1. Një pjesë e situatave.
- 2. Allianz... në stadiumein e Bayern.
- 25. Andrea ish-mesfushor i Dinamos.
- 30. Personzhi në foto.
- 36. Zatopek që qe atlet i famshëm.
- 37. Lika portier.
- 38. Personazhi në foto.
- 40. Inicialet e Berlusconi-t.
- 41. Kështu thiren lojtarët e Zelandës së Re në rugby.

- 43. Marco, ish-mesfushor italian.
- 46. Mbyllin një spital.
- 47. Koço dirigjent.
- 48. Laurent, ish-trainer i Francës.
- 51. Räikkönen pilot.
- 53. Skuadra e Totti-t.
- 54. Eshhtë drejtor sportiv te Lazio.

- 18. Kërcimi i brazilianëve.
- 19. Marcelo që thirrej Matador.
- 20. Fillojnë nazet.
- 23. Andrea aktore.
- 24. Xhellaj aktor.
- 25. Kështu thiren treneri në Itali.
- 26. Janku i arbritrave.
- 27. Qendër kurimi
- 28. Knock Out.
- 29. Fillon nga fundi.
- 31. I ka tek krimbi.
- 32. Mauricio te Juventus.

- 33. Mbrojtës... anglez.
- 34. Agjenci Këmbimi Korçë.
- 35. Pastaj në fund.
- 41. Një Myslym dikur trainer.
- 42. Muhammad i ringut.
- 44. Një cigan.
- 45. Inicialet e Bearzot.
- 46. Një pjesë e amerikanëve.
- 49. Inicialet e Goldoni-t.
- 50. Sikur janë në krye.
- 51. Kafen të parat.
- 52. Mirë në qendër.

VERTIKAL

- 1. Sapo fillojnë.
- 2. Casillas portier.
- 3. Frazier-ish kampion io ringut.
- 4. Diftong poetik.
- 5. Një pjesë e aderuesve.
- 6. Një pikë në ligj.
- 7. Gjysma e rripit.
- 8. Eshhtë lojtari pas stopper-it.
- 9. Fillojnë javën
- 10. Të parat në fluturim.
- 11. Eshhtë vija e portës.
- 13. Giorgio te Juventus.
- 17. Eshhtë edhe ajo e klasifikimit.

PËRGJIGJA E FJALEKRYQIT SPORTIV



FJALEKRYQI PA SKEME

DUHET TË NXINI 34 KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	

HORIZONTAL

- 1. Atomike ajo e Salvador Dalit.
- Ekstremer në mëngjes.
- Fillimi i filmit.
- Mund të jetë çiklistik.
- 2. Një britmë në corrida.
- Evira akore.
- Skuadra merengue.
- 3. Fund tuneli.
- Mund të jetë edhe sporti të tilla
- Eshhtë e tretë ajo e pensionistit
- 4. Dy asa.
- Janë kandidateshinat pa dokumenta.
- Të parat në stadium.
- 5. Në hyrje të sallës
- Ai dhe ajo.
- Kufizojnë lëvizjet
- Inicialet e Paganini-t.
- Dimër pa ekstreme.
- 6. Eshhtë vjedhja.
- Emri i Stravinskijt.
- Eshhtë legjenda.
- 7. Inicialet e Kokoschka-s.
- Eshhtë raca e një kombi
- Morissette këngëtare.
- 8. Gjysma e danave
- Inicialet e turgeniev.
- Eshhtë individ.

VERTIKAL


- Fund shkurti
- 9. Lidhin brigje.
- Fiks... në Top Channel.
- Janë tek në guvë.
- Gjysmë dekuri.
- 10. Janë sportistët me stil të lirë.
- Ishin pallatet e beut
- Fillojnë romanin.
- 11. Kanë marrë fjalën.
- Janë edhe atotë Bashkuara Arabe.
- 12. Janë si dallgëzime.
- Një rival e Volvo-s.
- Mbyllin reparte

VERTIKAL

- 1. Frolich e Marlene Dietrich.
- Boris që ishte car.
- 2. Canetti i Auto- da- fé.
- Tregon martesë
- 3. Mbyllin kënde.
- Inicialet e Kurosawa.
- Provinca e boerëve.
- 4. Inicialet e Eluard.
- Diftong në duel.
- Sharon që qe aktore.
- 5. Prokusi së guhë në të vjetërtë.
- Proza pa ekstreme.
- 6. Një ushtar i partisë.


- 12. Fillojnë ritmin.
- Merret me prodhimin e verës
- 13. Kështu thuhet shpes se janë vitet e rinisë.
- 14. Ramazzaotti këngëtar
- Fillojnë nisjen.
- Gjysmë tabelle.
- 15. Bëhet për provë.
- 16. Shahu pa ekstreme.
- Janë enigme.
- 17. Janë barna.
- Eshhtë munda pa doli

PËRGJIGJA E FJALEKRYQIT PA SKEME




I KRIPTOGRAFUAR

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË



PËRGJIGJE E NUMRIT TË KALUAR



HOROSKOPI



DASHI
Edhe pse do dëshironi te kaloni me tepër kohë me partnerin, nuk do e keni këtë mundësi. Te dy do jeni shume te angazhuar dhe nuk do mundeni dot te shkëputeni. Beqaret do ndihen mjaft mirë ashtu si janë dhe nuk do e kërkojnë me ngulim princin e tyre te kalter.



DEMI
Pozicionimi i yjeve nuk do jetë shume i mire gjate kësaj dite sa për te ndikuar pozitivisht tek jete juaj ne çift. Çdo gjë do jete si zakonisht dhe here pas here mund te keni debate te vogla. Beqaret do jene mendjemëdhenj dhe kjo do i beje te tjerët te mos ju afrohen shume.



BINJAKET
Do jeni shume serioze ne jete shume ne çift gjate kësaj dite dhe do e hidhni çdo hap pasi ta keni menduar mire. Nuk pritret pasion i zjartë, por as probleme. Beqaret do kenë një dite harmonike dhe plot emocione. Do ndiheni mire edhe ashtu si jeni, por as takimet nuk do mungojnë.



GAFORRJA
Adrenalina do shtohet gjate kësaj dite ne jetën tuaj ne çift dhe emocionet do jene te papërkrahshme. Shfrytëzojeni ditën deri ne minutën e fundit. Beqaret nuk duhet te ëndërrrojnë me shume sesa duhet sepse do përballen me zhgënjime.



LUANI
Konfigurimi i yjeve do jete pozitiv gjate kësaj dite dhe ju do jeni me te qarte për atë qe doni te bëni. Shprehani gjithçka partnerin ne mënyrë qe lidhja juaj te ece ne rugën e duhur. Ne planin financiar do e dini mire çfarë hapash te hidhni qe situata te stabilizohet.



VIRGJËRËSHA
Dite mjaft pozitive dhe interesante kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do ndiheni për mrekulli ne krahet e partnerit tuaj dhe mund te merrni edhe vendime mbi te ardhmen. Për beqaret nuk do ketë dashuri ne këto momente. Duhet ende te bëni pak durim.



PESHORJA
Dite mjaft e animuar dhe e dukur kjo për te dashuruarit. Do përjetoni emocione te shumëfishta dhe do doni qe ato momente te mos mbaronin kurrë. Beqaret nga ana tjetër do jene sharmante dhe do e kenë me te lehte për ta bere për vete personin qe pëlqejnë.



AKREPI
Nëse jeni ne një lidhje qe prej kohësh sot do mendoni te hidhni disa hapja me te. Do përjetoni emocione për këtë fakt dhe disa do kenë frike për gjërat qe mund te ndodhin. Për beqaret nuk priten surpriza te mëdha gjate kësaj dite.



SHIGJETARI
Kjo sotmja do jete një nga ditët me te bukura te jetës suaj. Do kaloni momente pasionante dhe emocionuese me partnerin dhe do merrni edhe një propozim te mrekullueshëm prej tij. Beqaret gjithashtu do jene me fat ne dashuri. princi i kalter do jete shume afër tyre.



BRICJAPI
Sot do i tregoni edhe njëherë partnerit tuaj sa shume e dashuron dhe marrëdhënia me te do filloje te ngrohët akoma me tepër. Ne mesdite mund te merrni edhe një dhurate surprize prej tij. Ne planin financiar do e keni te nevojshme te hignj dorja nga shpenzimet e mëdha.




UJORI
Dite mjaft premtuese kjo e sotmja për te dashuruarit. Do filsi hapës për gjithçka qe ju shprehon dhe me mirëkuptim do jeni edhe zgjidhjen e duhura. Beqaret do bëjnë për vete shume persona dhe do arrijnë me pas te zgjedhin personin e duhur. Do ndiheni me te qete ne këtë sektor.




PESHQIT
Me me shume komunikim dhe bashkëpunim ne jetën tuaj ne çift do mund t'i sqaroni mosmarrëveshjet dhe debatet qe keni pasur. Kjo do ju beje te ndiheni me te qete. Beqaret do mahellen nga personat qe do takojnë dhe do bëjnë gjithçka për t'i joshur.

SUDOKU



PËRGJIGJE E NUMRIT TË KALUAR



**LAJME
NGA BOTA**

Inspektorët e OKB kontroll gjithë pikave në Siri

Ekspertët e ngarkuar me shkatërrimin e arsenalit kimik kanë inspektuar tashmë 22 prej 23 vendprodhimeve të deklaruara nga Siria, bëri dje të ditur Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike (OPCW). Ajo theksoi se përfundoi inspektimin e njërit prej vendprodhimeve të shmangura për arsye sigurie me anë të kamerave. "Misioni i përbashkët i OPCW-së dhe OKB-së ka inspektuar tashmë 22 nga 23 vendprodhime", citon një komunikatë e organizatës. "Në përputhje me deklaratat e Sirisë, vendprodhimi ishte i demontuar dhe i braktisur prej shumë kohësh ndërsa ndërtesa e boshatisur dhe e demtuar si pasojë e luftimeve", citon më tej komunikata.

Thaçi: Mbaruan pretendimet e Serbisë ndaj Kosovës

Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, në një intervistë për televizionin boshnjak BHT, ka thënë se Serbia ka pasur pretendime territoriale ndaj Kosovës, por përpjekjet e saj kanë qenë të pasuksesshme. "Tani kemi marrëveshjen e 19 prillit me Serbinë. Kosova është sovranë dhe e pavarur, me integritet territorial të pranuar ndërkombëtarisht. Askush nuk mund të aspirojë për të ndryshuar kufijtë e rajonit", - ka thënë Thaçi. I pyetur nëse Serbia do të jetë e gatshme të pranojë pavarësinë e Kosovës, Thaçi ka thënë se "tash për tash, është e rëndësishme të punohet në normalizimin e marrëdhënieve".

Jaser Arati vdiq nga rrezatimi me polonium

Një raport mjeko-ligjor zvicerian ka zbuluar se ish-lideri palestinez Jasser Arafat u helmua. Arafat vdiq në vitin 2004 nga poloniumi radioaktiv. Një skuadër ekspertësh zhvargosi eshtrat e Jasser Arafat në qytetin e Ramallah, nëntorin e kaluar dhe mori mostra të ndryshme për të kërkuar shenja helmimi. Tashmë, pas zbulimit të këtyre lajmeve, palestinezët akuzojnë Izraelitët si fajtorë të vrasjes së liderit të tyre. Por qeveria izraelite ka mohuar se ka pasur rol në vdekjen e Arafat duke thënë se ai ishte një 75-vjeçar dhe kishte një mënyrë jetese jo të shëndetshme. Asnjë autopsy nuk u krye mbi trupin e ish-liderit palestinez.

Turqia, negociata të shpejta anëtarësimi në BE

"Turqia pret negociata më të shpejta për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, deklaroi kryeministri turk Rexhep Taip Erdogan". Deklarata e tij vjen menjëherë pas hapjes së kapitullit të 22-të të negociatave me BE-në. Erdogan shfaqti shpresë se kapitujt e hapur do të mbyllin shpejt. Prej 35 kapitujve të negociatave deri tani është mbyllur vetëm një. Bashkimi Evropian dhe Turqia hapën dje në Bruksel një kapitull të ri bisedimesh për negociatat e anëtarësimit të vendit duke theksuar vullnetin e tyre për përshtetimin e procesit pas tre vjetësh paralize. "Kjo është një pikë kthimi në marrëdhëniet mes BE-së dhe Turqisë pas një ngërçi 40 mujor", theksoi ministri turk për Çështjet Evropiane, Egemen Bagis, pas mbledhjes së 10-të për anëtarësimin e Turqisë.

Policia greke, dhunë ndaj punonjësve të ERT

Policia greke ka ndërhyrë me forcë në zyrat qëndrore të televizionit shtetëror ERT. Në godinë gjendeshin ende ish-punonjësit, të cilët e kishin okupuar ndërtesën që pas heqjes së sinjalit të saj në qershor, si pjesë e masave qeveritare për të ulur shpenzimet. Pas urdhrës të prokurorisë, policia hyni në godinë në orët e para të së enjtes dhe largoi ish-punonjësit. Që prej heqjes së sinjalit të televizionit shtetëror në qershor, ish-punonjësit të cilët refuzuan të praninin këtë vendim ishin mbyllur brenda godinës dhe transmetonin në lidhje direkte.



ju sjellim lumturi
në cdo stinë



Paketat	ADSL 2+				Fibër Optike
Shpejtësia	1 Mbps	2 Mbps	6 Mbps	8 Mbps	50 Mbps
Çmimi	900 Lekë	1,200 Lekë	1,400 Lekë	2,000 Lekë	5,500 Lekë

* Paketat janë pa limit. Instalimi ofrohet falas. Çmimet janë të vlefshme për parapagimit 1 vjeçar. TVSh e përfshirë në çmim.

Rr. Ismail Qemali, ish Blloku. Tiranë
Tel: 044300123

www.abissnet.al
sales@abissnet.al

• Alba Malltezi
Drejtoresh e Përgjithshme
e Free and Fair Media Group

• Gene Kondi
Kryeredaktor

• Admirina Peçi,
Kryeredaktore e "Rilindasi"
Politika: Jakin Marena

Aktualitet: Elton Qyno
Sociale: Ilir Sinanaj
Kulturë: Dhuratata Hamzai
Sporti: Dylber Balla

Design: Altin Aliaj
Genti Manelli
Website: Suela Gera

Departamenti i Marketingut:
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Shpërndarja:
Spiro Meshini
cel: +355696088847
cel: +355696060418

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: A.K shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë